

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXV, nr. 7973
E martë, 21 janar 2025
Çmimi 0.50

Izraeli i liron
të burgosur palestinezë
pasi Hamasi i ktheu
3 pengje | FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

DONALD TRUMPI MERR DETYRËN E PRESIDENTIT TË 47 TË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS

TRUMPI RIKTHEHET NË SHTËPINË E BARDHË



Në sallën e Kongresit amerikan, presidenti i 47 i ShBA-së, Donald Trump, ka bërë betimin. Ai është rikthyer në Shtëpinë e Bardhë pas mandatit të parë që kishte nga viti 2017 deri më 2021. Sipas traditës, Trumpi dhe

gruaja e tij, Melania, u pritën fillimisht në Shtëpinë e Bardhë nga Bideni dhe gruaja e tij, Jill, për të pirë çaj. Ceremonia e inaugurimit është zhvilluar në një rreth më të ngushtë për shkak të motit të ftohtë, me

rreth 600 pjesëmarrës që ishin dëshmitarë të ndryshimit të pushtetit brenda Kapitolit. Trumpi u zotua se do të veprojë me shpejtësi dhe forcë historike që të zgjidhë çdo krizë me të cilën përballet ShBA-ja

NATO-ja DHE BE-JA PËRFORCOJNË KONTINGJENTET NË KOSOVË PARA ZGJEDHJEVE TË 9 SHKURTIT F. 4



PETER SORENSEN PRITET TË JETË PASARDHËSI I LAJÇAKUT PËR DIALOGUN KOSOVË-SERBI F. 3



AKTUALE



KARDIOKIRURGJIA SHËNON NUMËR REKORD TË OPERIMEVE NË ZEMËR TË HAPUR F. 7

OSMANI THEKSON NEVOJËN E NGRITJES SË NIVELIT TË BASHKËPUNIMIT STRATEGJIK ME BRITANINË PËR ANËTARËSIM NË NATO F. 3

FSK-ja FILLON LIGJËRATAT PËR VETËDIJESIMIN NGA RREZIKU I MINAVE F. 5

EKONOMI



A PO KEQPËRDORËN PUNËTORËT E BANGLADESHIT NGA KOMPANITË NË KOSOVË? F. 8

BIZNESMENI KLINAS VODHI MBI 16 500 EURO RRYMË F. 8

SPORT



KRYEZIU DHE RASHKAJ EMËROHEN NDIHMËSTRAJNERË NË EKIPET PËRFAQËSUESET U21 E U19 F. 10

RENOVA
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
PUTZ
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Bideni i fal Faucin dhe Milley'n pak orë para se Trumpi ta marrë detyrën

PRISHTINË, 20 JANAR - Presidenti amerikan në shkuarje, Joe Biden, i ka falur doktorin Anthony Fauci, gjeneralin e pensionuar Mark Milley, si dhe anëtarë të komitetit të Dhomës së Përfaqësuesve që e hetuan sulmin e 6 janarit në Kongres. Bideni e përdori pushtetin e tij të jashtëzakonshëm në orët e fundit si president për t'i mbrojtur ata nga hakmarrja e mundshme e administratës së Trumpit, e cila mori detyrën sot pasdite.

Ky vendim i Bidenit erdhi pasi Trumpi kishte paralajmëruar për një listë armiqsh të mbushur me njerëz që e kishin kundërshtuar atë politikisht, apo kishin tentuar ta mbanin përgjegjës për përpjekjet e tij për ta zhbërë humbjen në zgjedhjet e vitit 2020 dhe rolin e tij në sulmin që ndodhi në Kongresin amerikan më 6 janar 2021.

Trumpi ka zgjedhur anëtarë të kabinetit ata të cilët i

mbështetën pretendimet e tij për zgjedhjet e vitit 2020 dhe të cilët janë zotuar se do t'i ndëshkojnë personat që bënë përpjekje për ta hetuar Trumpin. "Këto falje nuk duhet të ngatërrohet si një pranim se ndonjë individ ka kryer ndonjë vepër të keqe, as pranimi i tyre nuk duhet të interpretohet si një pranim fajësie për ndonjë vepër penale", tha Bideni në një komunikatë. "Kombi ynë ua ka borxh këtyre shërbyesve publikë një mirënjohje të madhe për angazhimin e tyre të palodhshëm ndaj vendit tonë", tha ai.

Është zakon që një president të falë të dënuar në fund të mandatit të tij, por këto akte mëshire zakonisht u ofrohen amerikanëve të zakonshëm që janë dënuar për ndonjë krim. Por, Bideni e ka përdorur këtë fuqi në mënyrën më të gjerë: për të falur ata që nuk janë hetuar ende. Dhe me pranimin e faljes vjen një pranim i



heshtur fajësie ose keqbërjeje, edhe pse ata që janë falur nuk janë akuzuar zyrtarisht për ndonjë krim.

Fauci ishte drejtor i Institutit Kombëtar për Alergjji dhe Sëmundje Infektive në ShBA për gati 40 vjet dhe këshilltari kryesor shëndetësor i Bidenit deri në pensionimin e tij në vitin 2022. Ai ndihmoi në koordinimin e reagimit të kombit ndaj pandemisë Covid-19 dhe ngjalli zemërimin e

Trumpit kur refuzoi t'i mbështeste pretendimet e pabaza të tij.

Fauci ishte shënjestër e urrejtjes dhe sulmeve të ashpra nga njerëz të së djathtës, të cilët e fajësojnë atë për bartjen e detyrueshme të maskave dhe politikave të tjera që ata besojnë se kufizuan të drejtat e tyre, edhe pse dhjetëra mijëra amerikanë po vdisnin.

Mark Milley është ish-kryetar i Shtabit të Përgjithshëm dhe e

quajti Trumpin fashist dhe tregoi hollësi për sjelljen e Trumpit gjatë kryengritjes vdekjeprurëse të 6 janarit 2021. Bideni i ka falur edhe anëtarët dhe stafin e komisionit të 6 janarit, duke përfshirë ish-përfaqësuesit Liz Cheney dhe Adam Kinzinger, të dy republikanë, si dhe oficerët e Policisë së Kapitolit të ShBA-së dhe Policisë Metropolitane të Uashingtonit që dëshmuuan para komisionit.

Bideni ka premtuar kalim të qetë të pushtetit, duke e ftuar Trumpin në Shtëpinë e Bardhë dhe duke thënë se kombi do të jetë në rregull, edhe pse ai paralajmëroi gjatë fjalimit të tij të lamtumirës për një oligarki në rritje. Ai ka kaluar vite duke paralajmëruar se rikthimi i Trumpit në presidencë do të ishte kërcënim për demokracinë. Vendimi i tij për t'i thyer normat politike me faljet paraprake u motivua nga këto shqetësime.

Izraeli i liron 90 të burgosur palestinezë, pasi Hamasi i ktheu 3 pengje

JERUSALEM, 20 JANAR - Izraeli i ka liruar 90 të burgosur palestinezë të hënën në mëngjes, pasi tri pengje izraelite u liruan nga Hamasi në Gazë dhe u rikthyen në Izrael një ditë më parë.

Një autobus i madh i mbushur me të burgosur palestinezë u largua nga burgu Ofer i Izraelit, i cili ndodhet në afërsi të qytetit Ramallah në Bregun e okupuar Perëndimor.

Ushtria izraelite, e cila e ka uzurpuar Bregun Perëndimor, i paralajmëroi palestinezët të mos festonin në publik, por turmat përcollën autobusët të cilët u larguan nga burgu, me disa prej tyre që u ngjiten mbi ta apo valëvitën flamuj, përfshirë atë të Hamasit - grupit palestinez të shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian.

Sipas një liste të lëshuar nga Komisioni për Çështjet e të Burgosurve i Autoritetit



Palestinez, të gjithë të liruairt janë gra ose adoleshentë, më i riu 15 vjeç. Izraeli tha se i kishte arrestuar ata për vepra që lidhen me sigurinë e Izraelit, nga hedhja e gurëve deri tek akuzat më serioze si tentativa për vrasje. Lirimi i tri pengjeve izraelite dhe 90 të burgosurve palestinezë është hapi i parë i marrëveshjes së armëpushimit mes Izraelit dhe Hamasit që hyri në fuqi të dielën.

Në mbarë enklavën palestineze pati festime të dielën dhe disa palestinezë nisën të ktheheshin në shtëpitë e tyre të rrënuara, edhe pse vonesat në hyrjen në fuqi të armëpushimit vunë në pah brishtësinë e marrëveshjes. Kombet e Bashkuara njoftuan se kamionë me ndihmë humanitare kanë nisur të hyjnë në Gazë pas nisjes së armëpushimit. Armëpushimi, që u arrit pas një viti të ndërmjetësimit intensiv

nga ShBA-ja, Katari dhe Egjipti, është hapi i parë në një proces të gjatë e të brishtë që synon t'i japë fund luftës 15-mujore. Ajo parasheh dhënien fund të luftës dhe lirin e pothuajse 100 pengjeve që u morën gjatë sulmit të Hamasit në Izrael më 7 tetor 2023, ku militantët vranë 1 200 njerëz gjithashtu.

Në fazën e parë 42-ditore të armëpushimit është paraparë të lirohen 33 pengje që mbahen në Gazë dhe qindra të burgosur palestinezë që mbahen në Izrael.

Pakti parasheh që Izraeli të tërhiqet në një zonë brenda Gazës dhe shumë palestinezëve të zhvendosur t'u mundësohet kthimi në shtëpinë e tyre. Po ashtu, parashihet rritje e ndihmave humanitare për Gazën.

Ky është armëpushimi i dytë që hyn në fuqi që kur nisi lufta në tetorin e vitit 2023, pasi mbi një vit më parë palët kishin ndërprerë luftimet për një javë

dhe gjatë asaj periudhe u liruan disa pengje.

Negociatat për fazën e dytë, që konsiderohet më e vështirë, është paraparë të nisnin dy javë më vonë. Megjithatë, ka shumë pikëpyetje për këtë çështje, përfshirë edhe atë nëse lufta do të rinisë pas fazës së parë gjashtëjavore dhe si do të lirohen pjesa tjetër e pengjeve. Lufta në Gazë ka shkaktuar viktima të shumta dhe dëme të mëdha materiale. Si pasojë e ofensivës izraelite janë vrarë më shumë se 46 000 palestinezë. Mbi 90 për qind e popullsisë prej 2.3 milionë banorësh është zhvendosur. Kombet e Bashkuara kanë thënë se sistemi i shëndetësisë, rrjeti rrugor dhe infrastruktura vitale janë dëmtuar rëndë.

Rindërtimi - nëse armëpushimi arrin në fazën e tij finale - do të merrte kohë disa vite. Po ashtu, çështje e pazgjidhur mbetet edhe se si do të udhëhiqet Gaza pas konfliktit.

"TikTok"-u i rikthen shërbimet në ShBA pas zotimit të Trumpit

WASHINGTON, 20 JANAR - "TikTok"-u i riktheu shërbimet për 170 milionë përdoruesit e vet në Shtetet e Bashkuara të dielën, pasi presidenti i zgjedhur amerikan, Donald Trump, u zotua se do ta përdorë një urdhër ekzekutiv për ta pezulluar ndalesën federale

ndaj platformës sapo ta marrë pushtetin të hënën. Trumpi tha se do ta përdorë urdhrin ekzekutiv për t'i dhënë më shumë kohë aplikacionit të videove, i cili është në pronësi të ByteDance nga Kina - për ta gjetur një blerës të pranueshëm, para se ndalesa

e urdhëruar nga Gjykata Supreme të zbatohet plotësisht.

"TikTok"-u i ndali shërbimet në ShBA dhe u zhduk nga tregjet e aplikacioneve të Apple dhe Google të dielën, disa orë para se të hynte në fuqi ligji që kërkon ndalimin e tij.



Peter Sorensen pritet të jetë pasardhës i Lajçakut për dialogun Kosovë - Serbi

PRISHTINË, 20 JANAR - Përfaqësuesja e lartë e Bashkimit Evropian për politikë të jashtme dhe siguri, Kaja Kallas, ka vendosur që diplomati nga Danimarka, Peter Sorensen, të jetë përfaqësues i posaçëm për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë. Këtë pozitë aktualisht e mban Miroslav Lajçak.

Radio Evropa e Lirë ka mësuar nga burime diplomatike në BE se emri i Sorensenit është dërguar për miratim edhe të vendet anëtare të bllokut.

Kandidatura e tij do të jetë në rend dite në takimin e Komitetit për Politikë dhe të Sigurisë së BE-së (PSC), ku janë përfaqësuesit e të gjitha vendeve anëtare.

Burimet diplomatike thanë se, sipas praktikës nga e kaluara, konfirmimi i Sorensenit nga vendet anëtare do të jetë vetëm procedurë formale, pasi tashmë Kallas e ka zgjedhur atë të dërguar të posaçëm për dialogun.

Përfaqësuesit e posaçëm të BE-së emërohen nga kryediplomatja e bllokut, por emërimi i tyre duhet të konfirmohet edhe nga vendet anëtare në Këshill.

Pritet që Sorensen të konfirmohet në postin e emisarit për dialog deri në fund të këtij muaji, në mënyrë që nga fillimi i shkurtit ta nisë

mandatin.

Të dërguarit aktual, Lajçak, i skadon mandati më 31 janar. Sorensen nga Danimarka ka përvojë të gjatë diplomatike në strukturat e BE-së. Ai aktualisht është këshilltar i lartë në Shërbimin e Veprimit të Jashtëm të BE-së (EEAS) për diplomaci digjitale. Gjatë karrierës së tij diplomatike në BE, Sorensen ka ushtruar disa detyra në Ballkanin Perëndimor. Ka shërbyer si përfaqësues i posaçëm i BE-së për Bosnjë-Hercegovinë dhe shef i zyrës së BE-së në Sarajevë. Po ashtu, ka qenë edhe shef i delegacionit të bllokut evropian në Shkup.

Më herët Sorensen ka punuar këshilltar edhe në Kosovë në misionin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), ndërsa ka qenë edhe përfaqësues i posaçëm i përfaqësuesit të lartë të BE-së në Serbi. Në Ballkan ai ka punuar edhe në misionin e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në Kroaci.

Përvoja e tij nga rajoni thuhet se ka qenë edhe një prej argumenteve se pse Kaja Kallas ka vendosur që ai të jetë pasardhësi i Lajçakut.

Burimet diplomatike në BE i thanë Radios Evropa e Lirë që Sorensen pritet të jetë vetëm i dërguar i posaçëm për dialogun Kosovë - Serbi dhe



nuk do të ketë detyrime të tjera lidhur me Ballkanin Perëndimor, siç ka pasur paraardhësi i tij.

Për postin e lehtësuesit të dialogut ishte përmendur edhe emri i ish-ministrit të Jashtëm të Finlandës, Pekka Haavisto, i cili, po ashtu, ka njohuri për zhvillimet në Ballkanin Perëndimor. Në Kosovë Haavisto ka qenë nënkryetar i "Shtyllës IV" (Rindërtimi dhe Zhvillimi Ekonomik) të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), nga viti 2002 deri në vitin 2006,

si dhe këshilltar i lartë i përfaqësuesit të Posaçëm të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së në Kosovë nga viti 2001 deri më 2002.

Për këto rol ishte përmendur edhe emri i ish-presidentit dhe ish-kryeministrit të Sllovenisë, Borut Pahor. Vitin e kaluar ai pranoi se ishte i interesuar për këtë post, por gjatë janarit të këtij viti tha se nuk do të garonte, pasi ka kuptuar se kërkohet më shumë një nivel diplomatik sesa politik.

Gjatë mandatit gati pesëvjeçar të Lajçakut Kosova dhe Serbia kanë arritur Marrëveshjen për

normalizim të raporteve. Marrëveshja, e cila nuk është nënshkruar, është ligjërisht e obligueshme për palët, ka thënë blloku. BE-ja i ka akuzuar Kosovën dhe Serbinë për mosnismën e zbatimit të paktit, duke thënë se kjo do të ndikojë në rrugëtimin e dy shteteve drejt integriteteve evropiane.

Dialogu për normalizimin e raporteve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian, ka nisur më 2011. Gjatë procesit janë arritur disa marrëveshje, por pak prej tyre janë zbatuar në terren.

Osmani thekson nevojën e ngritjes së nivelit të bashkëpunimit strategjik me Britaninë për anëtarësim në NATO

EPOKA ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 20 JANAR - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të hënën në takim ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, Jonathan Hargreaves. Gjatë takimit, presidentja shprehu mirënjohjen për mbështetjen e vazhdueshme të Mbretërisë së Bashkuar ndaj Kosovës si dhe për rolin thelbësor në procesin e shtetndërtimit.

Diskutimet u fokusuan në bashkëpunimin e ngushtë dypalësh në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, duke vlerësuar mbështetjen e vazhdueshme të Mbretërisë së Bashkuar në reformat institucionale dhe promovimin e sundimit të ligjit, ndaj presidentja Osmani falënderoi Mbretërinë e Bashkuar për mbështetjen e deritashme në fushën e mbrojtjes.

Më tej, Osmani shtroi nevojën e ngritjes së nivelit të bashkëpunimit strategjik në këtë fushë, si hap drejt përgatitjes së

Kosovës për anëtarësim në NATO.

Presidentja Osmani, po ashtu, falënderoi Mbretërinë e Bashkuar për programin e bursave Chevening dhe diskutoi mundësitë për zgjerimin e shkëmbimeve arsimore dhe kulturore, si dhe për forcimin e partneritetit në këto fusha.

Në këtë kontekst, presidentja Osmani theksoi rëndësinë e bashkëpunimit të ndërsjellë për adresimin e sfidave dhe avancimin e aspiratave të përbashkëta, duke shfaqur gatishmërinë për thellimin e mëtejshëm të marrëdhënieve midis dy vendeve në të gjitha fushat.

Osmani takon ambasadorin e Turqisë, diskutojnë për thellimin e raporteve bilaterale mes dy vendeve

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të hënën në takim ambasadorin e



Republikës së Turqisë në Kosovë, Sabri Tunç Angili, me të cilin kanë diskutuar për zhvillimet e fundit politike në vend si dhe për thellimin e mëtejshëm të raporteve bilaterale me Turqinë.

Gjatë takimit presidentja Osmani vlerësoi mbështetjen e vazhdueshme të Turqisë dhe marrëdhëniet miqësore

ndërmjet dy shteteve, duke potencuar se Turqia mbetet partnere strategjike dhe mbështetëse e fuqishme e Kosovës.

Presidentja Osmani shtroi nevojën e vazhdimin të mbështetjes turke ndaj Kosovës për anëtarësim në organizatat ndërkombëtare, njohje të

mëtejshme dhe vazhdim të thellimit të bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes.

Të dy bashkëbiseduesit u pajtuan për thellimin e bashkëpunimit dhe avancimin e interesave të përbashkëta të të dyja shteteve, duke përforcuar lidhjet miqësore dhe bashkëpunimin afatgjatë.



DONALD TRUMPI MERR DETYRËN E PRESIDENTIT TË 47 TË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS

Trumpi rikthehet në Shtëpinë e Bardhë

Në sallën e Kongresit amerikan, presidenti i 47 i ShBA-së, Donald Trump, ka bërë betimin. Ai është rikthyer në Shtëpinë e Bardhë pas mandatit të parë që kishte nga viti 2017 deri më 2021. Sipas traditës, Trumpi dhe gruaja e tij, Melania, u pritën fillimisht në Shtëpinë e Bardhë nga Bideni dhe gruaja e tij, Jill, për të pirë çaj. Ceremonia e inaugurimit është zhvilluar në një rreth më të ngushtë për shkak të motit të ftohtë, me rreth 600 pjesëmarrës që ishin dëshmitarë të ndryshimit të pushtetit brenda Kapitolit. Trumpi u zotua se do të veprojë me shpejtësi dhe forcë historike që të zgjidhë çdo krizë me të cilën përballet ShBA-ja

Trumpi e cilësoi atë si një "përparim të madh" në marrëdhëniet mes dy vendeve. Atëkohë ai pati thënë se është "krenar për dy udhëheqësit" - kryeministrin e atëhershëm të Kosovës, Avdullah Hoti, dhe presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq. Në sigurimin e asaj marrëveshjeje rol të rëndësishëm luajti Richard Grenell, që asokohe shërbente i dërguar i posaçëm i ShBA-së për dialogun Kosovë - Serbi. Për këtë arritje ai u dekorua edhe me Medaljen e Sigurisë Kombëtare nga Trumpi në dhjetor të vitit 2020. Përveç tij kishte edhe zyrtarë të tjerë të administratës së parë Trump që mbështetën ide për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Një prej tyre ishte John Bolton, atëkohë këshilltar për sigurinë kombëtare i Shtëpisë së Bardhë, i cili nuk i përjashtoi si mundësi korrigjimet territoriale mes dy vendeve. "Ne nuk do të jemi pengesë dhe nuk mendoj se dikush në Evropë do të qëndrojë në mes nëse të dyja palët në konflikt arrijnë një marrëveshje të kënaqshme", tha Boltoni në gusht të vitit 2018.

Në administratën e re, Trumpi zgjodhi republikanin Mike Waltz në pozitën e këshilltarit për siguri kombëtare. Ndonjë deklaratë e tij për Kosovën nuk është publike, por është i zgjedhuri i Trumpit për sekretar të ri të Shtetit, Marco Rubio, i cili, përgjatë karrierës, e kishte disa herë në fokus rajonin e Ballkanit. Në vitin 2022 ai iu bashkua një grupi senatorësh, i

cili i dërgoi letër presidentit të atëhershëm amerikan, Joe Biden, për ta inkurajuar që ta mbajë Ballkanin në vëmendjen e tij. "Ballkani është një zonë e cenueshme e Evropës dhe, megjithëse Ukraina duhet ta ketë vëmendjen tonë të menjëhershme, ne nuk mund ta humbasim nga sytë këtë rajon, ku NATO-ja, prej kohësh, ka luajtur rol të rëndësishëm në ruajtjen e paqes", u tha në atë letër.

Vëzhguesit e zhvillimeve politike janë të rezervuar kur flasin për qasjen që pritet ta ketë Trumpi ndaj Kosovës gjatë katër vjetëve të ardhshëm.

Kosova aktualisht është në mes të fushatës për zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit; marrëdhëniet e tensionuara me Serbinë nuk kanë shënuar ndonjë përmirësim, e ngjashëm ka ngecur edhe avancimi i Kosovës drejt anëtarësimit në strukturat euroatlantike.

Ish-diplomati amerikan Cameron Munter tha në një intervistë të mëhershme për Radion Evropë e Lirë se rikthimi i Trumpit në Shtëpinë e Bardhë do të imponojë patjetër ndryshim të strategjisë në dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë pasi, sipas tij, Trumpi do marrëveshje. "Synim i tij nuk është t'i fusë serbët dhe kosovarët në Bashkimin Evropian. Synim i tij është ta bëjë më të mirën për Shtetet e Bashkuara, ta bëjë Amerikën sërish madhështore", tha Munter, ish-ambasador i ShBA-së në Serbi.

Frank Wisner, ish-emisar i ShBA-së për statusin e Kosovës, tha më

herët për Radion Evropë e Lirë se nuk e përjashton mundësinë që Trumpi ta eksplorojë ndarjen e Kosovës si zgjidhje të shpejtë për konfliktin e saj të vazhdueshëm me Serbinë. "Nëse ai sheh ndonjë marrëveshje me [presidentin e Serbisë, Aleksandar] Vuçiq, që i përshtatet, ai nuk do ta presë Kosovën që të bindet. Ai do të jetë transaksional, në kërkim të një marrëveshjeje, në kërkim të një përparimi, në kërkim të diçkaje që e bën të duket mirë. Kosova duhet të jetë e shkathtë, të sigurohet se ka mbështetje të fortë nga evropianët, por rrugëtimi i saj mund të jetë i vështirë", tha Wisner.

Për David Kaninin, profesor i Studimeve Evropiane në Universitetin "Johns Hopkins" në Uashington, administrata e parë e Trumpit ka qenë proserbe dhe zyrtarët serbë janë ndër të respektuar prej tij. "Humbësit, si gjithmonë, janë klientët e Amerikës: boshnjakët dhe kosovarët, por për këtë nuk duhet të fajësohet vetëm Trumpi. Ne kemi 30 vjet që i detyrojmë boshnjakët dhe kosovarët të bëjnë lëshime ndaj kundërshtarëve të tyre - qysh nga Marrëveshja e Dejtonit", tha Kanin, por shtoi se Trumpi, megjithatë, është i paparashikueshëm.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, dhe kryeministri Albin Kurti e uruan Trumpin për fitoren, duke e cilësuar ShBA-në aleate, mike dhe partnere të rëndësishme të Kosovës.

Dhjetë ditë para se Trumpi ta merrte detyrën, Osmani bëri me

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

UASHINGTON, 20 JANAR - Presidenti i zgjedhur amerikan Donald Trump, bashkë me presidentin në largim, Joe Biden, u takuan paraprakisht në Shtëpinë e Bardhë dhe pinë çaj. Për shkak të motit të ftohtë, ceremonia e inaugurimit të presidentit të ri është mbajtur brenda Kongresit dhe jo para ndërtesës së Kongresit, siç ndodh zakonisht. Bideni shërbeu në këtë pozitë një mandat katërvjeçar.

Donald Trumpi ka qenë president i ShBA-së edhe nga viti 2017 deri më 2021. Pas rizgjedhjes president, bëhet presidenti i parë i cili do të shërbejë në mandate jo të njëpasnjëshme që nga vitet 1890. Ceremonia e inaugurimit është zhvilluar në një rreth më të ngushtë për shkak të motit të ftohtë, me rreth 600 pjesëmarrës që ishin dëshmitarë të ndryshimit të pushtetit brenda

Kapitolit, në vend të ngjarjes tipike në mjedis të hapur për të cilën 250 000 veta kishin siguruar biletat.

Trumpi u zotua të dielën vonë se do të veprojë me shpejtësi dhe forcë historike që të zgjidhë çdo krizë me të cilën përballet ShBA-ja derisa u foli mbështetësve të tij në Uashington. Për betimin e presidentit të 47, Uashingtoni kishte ndërmarrë masa të forta sigurie.

Trumpi dhe Kosova

Gjatë mandatit të parë Trumpi dëshmoi nënshkrimin e një marrëveshjeje për normalizimin e marrëdhënies ekonomike midis Kosovës dhe Serbisë më 4 shtator të vitit 2020. Ndër pikat kryesore të asaj marrëveshjeje që gjetën zbatim të plotë, ishte njohja e ndërsjellë në mes të Kosovës dhe Izraelit.

Ndonëse shumë pika të tjera mbeten pa u zbatuar dhe palët fajësojnë njëra-tjetrën për këtë,

NATO-ja dhe BE-ja përforcojnë kontingjentet në Kosovë para zgjedhjeve të 9 shkurtit

PRISHTINË, 20 JANAR - NATO dhe Bashkimi Evropian po dërgojnë burime në Kosovë për zgjedhjet e rregullta parlamentare të 9 shkurtit. Aleanca ushtarake perëndimore e NATO-s tha se ka dërguar në Kosovë edhe 200 ushtarë shtesë italianë për ta forcur misionin e saj paqeruajtës në Kosovë, KFOR, i cili tani ka afër 4 000 trupa nga 50 000 sa kishte më 1999, kur ushtarët e këtij misioni u dislokuan në vend.

KFOR-i tha se po përforcon praninë në Kosovë dhe brigada italiane e këmbësorisë "Sassari" do të kryejë "një sërë aktivitete, së bashku me trupat e KFOR-it". Kjo forcë "do të disloket në përgjigje të çdo zhvillimi të rëndësishëm të situatës së sigurisë, përfshirë edhe gjatë periudhës së zgjedhjeve", tha KFOR-i.

Ditë më parë, shqetësime për periudhën zgjedhore në Kosovë shprehu edhe shefi i NATO-s, Mark Rutte. Ai deklaroi se është në kontakt me Kosovën dhe Serbinë, që të sigurohet që të mos ketë destabilizim gjatë zgjedhjeve parlamentare të 9 shkurtit.

Zgjedhjet parlamentare në Kosovë do të monitorohen po ashtu nga Bashkimi Evropian, i cili ka njoftuar për një mision prej 100 vëzhguesish.

Nathalie Loiseau, anëtarja franceze e Parlamentit Evropian, do të udhëheqë misionin e bllokut evropian për monitorimin e zgjedhjeve. Ajo ka deklaruar se ky mision vë në pah "mbështetjen e vazhdueshme të

BE-së për Kosovën për të forcur edhe më tej qeverisjen e saj demokratike". Ajo tha se votimet e 9 shkurtit do të tregojnë "pluralitetin e peizazhit politik të Kosovës".

Ky do të jetë misioni i shtatë vëzhgues i BE-së për zgjedhjet në Kosovë.

Fushata zgjedhore, e cila nisi më 11 janar, sipas organizatave joqeveritare në Kosovë që e monitorojnë këtë proces, po karakterizohet me gjuhë nxitëse dhe të urretjes mbi baza politike. Në zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit garojnë 28 subjekte politike dhe një kandidat i pavarur.

Katër kandidatët për kryeministër janë: Albin Kurti nga Lëvizja Vetëvendosje, Bedri Hamza nga Partia Demokratike e Kosovës, Lumir Abdixhiku nga Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Ramush Haradinaj nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës - ditët e para të fushatës i kanë përqendruar energjitë të politikave të brendshme dhe të akuzat ndaj njëri-tjetrit.

Këto zgjedhje shihen nga shumë si test për fuqinë e kryeministrit Albin Kurti dhe të partisë së tij, teksa tensionet janë të larta me minoritetin serb dhe me Serbinë fqinje. Asnjëri nga ta nuk ka përmendur si zotim kryesor normalizimin e raporteve me Serbinë.

Së fundi janë rritur tensionet për shkak të disa veprimeve të ndërmarra nga autoritetet e Kosovës në komunat ku jetojnë serbët. Më 15 janar, u mbyllën



institucione serbe në dhjetë komuna të Kosovës, pasi autoritetet në Prishtinë thanë se ato ishin institucione ilegale. Megjithatë, mbyllja e disa komunave paralele të Serbisë, si dhe zyra postare e tatimore në dhjetë komuna në jug të Ibrit, u përshkrua me kundërthënie, pasi Prokuroria Themelore në Prishtinë deklaroi po më 15 janar se nuk kishte autorizuar Policinë e Kosovës për kryerjen e këtij operacioni, pasi nuk kishte ndonjë kërkesë zyrtare. Mbyllja e institucioneve të tilla nga autoritetet e Kosovës ka nisur që në fillim të vitit 2024.

Përveç organeve të përkohshme komunale dhe ndërmarrjeve të tyre publike, janë mbyllur edhe Posta e Serbisë në veri, Banka Postare Kursimorë, Thesari i Bankës Kombëtare, Drejtoria e Fondit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor, Rrethi Administrativ i Mitrovicës së Kosovës dhe të tjera. Kryesisht kanë vazhduar të funksionojnë vetëm institucionet arsimore dhe shëndetësore, të cilat në zonat serbe gjithashtu punojnë në sistemin serb.

Serbët në veriun e Kosovës gëzojnë mbështetjen e Beogradit, i cili ka financuar strukturat

paralele atje, por edhe ka mbështetur qytetarët serbë përmes pensione apo edhe shtesave të tjera.

Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian kanë kundërshtuar shumë nga veprimet e Prishtinës në veriun e Kosovës, sikurse edhe Bashkimi Evropian, duke i vlerësuar si veprime të pakoordinuara. Blloku evropian u ka bërë thirrje Kosovës dhe Serbisë që të normalizojnë raportet në kuadër të dialogut të Brukselit, duke thënë se normalizimi është kusht për avancimin e shteteve drejt integriteteve evropiane.

FSK-ja fillon ligjëratat për vetëdijesimin nga rreziku i minave

PRISHTINË, 20 JANAR - Forca e Sigurisë së Kosovës me instruktorët e Kompanisë së Deminimit të Gardës Kombëtare kanë filluar realizimin e ligjëratave për nxënësit në shkollat fillore dhe

të mesme të ulëta në komunat e Kosovës me qëllim të ngritjes së vetëdijesimit të nxënësve për rrezikun që shkaktojnë minat dhe mjetet e tjera të ndryshme eksplozive të pashpërthyer që ndodhen në territorin e

Kosovës që nga lufta e fundit. Ky projekt realizohet në bashkëpunim në mes të Forcës së Sigurisë së Kosovës, Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe drejtorive komunale të arsimit dhe do të

mbahet për të gjitha komunitetet me qëllim të parandalimit të incidenteve me mina apo mjete të tjera të pashpërthyer të cilat gjenden në Kosovë dhe paraqesin rrezik për qytetarët e vendit.



dije se Kosova dhe ShBA-ja do të finalizojnë së shpejti një marrëveshje për dialog strategjik, me qëllim të avancimit të bashkëpunimit në fusha të ndryshme.

Trumpi zotohet përsëri se do t'i japë fund luftës në Ukrainë

Presidenti i zgjedhur i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, ka thënë përsëri se do t'i bëjë Ukrainën dhe Rusinë t'i japin fund luftës gati trevjeçare. Ai, gjithashtu, theksoi se do t'u kërkojë talebanëve t'ia kthejnë ShBA-së pajisjet e saj ushtarake në vlerë miliarda dollarë, të cilat ishin lënë pas në Afganistan në vitin 2021. "Unë do t'i jap fund luftës në Ukrainë, do ta ndal këtë rrëmujë në Lindjen e Mesme dhe do ta parandaloj Luftën e Tretë



Botërore", tha Trumpi në palestrën Capital Arena në Uashington të dielën, një ditë para se ta bëjë betimin. Ai nuk

shpjegoi se si do t'i arrijë këto. Analistët thonë se do të jetë e vështirë përfundimi i luftës në Ukrainë së shpejti, sepse

presidenti rus Vladimir Putin beson se ai po fiton dhe nuk është i nxitur për ta ndalur luftën.

Gjatë këtij tubimi, Trumpi bëri një përmbledhje të synimeve që ai pretendon se do t'i përmbushë gjatë katër vjetëve të ardhshme brenda dhe jashtë vendit, duke përfshirë forcimin e ushtrisë.

Gjatë fjalimit të tij, Trumpi pretendoi se Shtetet e Bashkuara po u japin talebanëve në Afganistan "miliarda dollarë në vit" dhe se ai do ta ndalojë këtë nëse grupi ekstremist nuk i kthen miliarda dollarë në pajisje amerikane. "Dhe unë them, nëse do të paguajmë miliarda dollarë në vit, duhet t'u themi atyre se nuk do t'ua japim paratë nëse nuk na i kthejnë pajisjet tona ushtarake", tha Trumpi.

Shtetet e Bashkuara lanë në Afganistan pajisje ushtarake të

vlefshme rreth 7 miliardë dollarë, kur u tërhoqën në gusht të vitit 2021, pasi talebanët rimorën kontrollin e kryeqytetit, Kabul.

Rimarrja e pushtetit nga talebanët ka çuar në një rënie drastike ekonomike, ku më shumë se gjysma e rreth 24 milionë banorëve të vendit kanë nevojë për ndihmë humanitare, si ushqim, sipas USAID-it, agjencisë amerikane për zhvillim.

Shtetet e Bashkuara ia kanë ndarë më shumë se 2.1 miliardë dollarë ndihmë humanitare Afganistanit që nga marrja e pushtetit nga talebanët, sipas USAID-it.

Që kur morën pushtetin, talebanët janë dënuar nga liderët perëndimorë, organizatat ndërkombëtare dhe aktivistët për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut, veçanërisht kundër grave dhe vajzave.

Rënia e kulmit në komunën e Prishtinës dhe lëndimi i 23-vjeçares, aktakuzë ndaj dy personave

PRISHTINË, 20 JANAR - Prokuroria Themelore në Prishtinë ka ngritur aktakuzë ndaj dy personave me inicialet Y.J. dhe B. B. për rastin e rrëzimit të kulmit të komunës së Prishtinës. Mirëpo, siç bëhet me dije në njoftim, është arritur marrëveshja për pranimin e fajësisë si dhe me rastin e ngritjes së aktakuzës i është propozuar gjykatës që të pandehurit të obligohen që ta kompensojnë dëmin material në shumën prej 36,450.29 eurosh. "Prokurori i Shtetit dhe të pandehurit kanë arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë si dhe me rastin e ngritjes së aktakuzës i është propozuar Gjykatës që të pandehurit të obligohen që ta kompensojnë dëmin material në shumën prej 36,450.29 eurosh që i është shkaktuar buxhetit të Republikës së Kosovës si dhe të ngarkohen me shpenzimet e procedurës

penale". Në njoftimin për medie thuhet: "Prokuroria Themelore në Prishtinë gjatë ditës së sotme pas një pune hetimore ka ngritur aktakuzë ndaj Y.J dhe B.B për rastin e rrëzimit të kulmit të Komunës së Prishtinës. I pandehuri Y.J. akuzohet se në cilësinë e personit zyrtar, si Menaxher i Kontratës 'Rikonstruimi i kulmit të objektit të Komunës së Re' në vlerë totale prej 386,096.20 euro, duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar ka vepruar në atë mënyrë që me dashje direkte dhe me qëllim që në mënyrë të kundërligjshme të përfitoj dobi pasurore kompania, ka përpiluar raport dhe ka pranuar se kine janë kryer punimet e kulmit të ndërtesës së Komunës së Re të Prishtinës edhe pse realisht aty nuk ishin bërë punimet sipas kontratës në pozicionet 2.2,



2.3, 5.1.5.13 dhe 5.14, duke ia mundësuar të kryhen pagesat në drejtim të kompanisë, në këtë mënyrë është dëmtuar buxheti i Republikës së Kosovës në shumën prej 36,450.29 euro, me çka ka kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar", thuhet në njoftim. Po sipas njoftimit, bëhet me

dije se: "Ndaj të pandehurit tjetër me inicialet B.B akuzohet se në cilësinë e personit përgjegjës të kompanisë, i cili ishte i ngarkuar në kryerjen e punimeve të mbikëqyrjes dhe kryerjes së punëve ndërtimore dhe përfundimit të punëve ndërtimore 'Rikonstruimi i kulmit të objektit të Komunës së Re', ka vepruar në

kundërshtim me standardet profesionale përgjithësisht të pranuar dhe në kundërshtim me kushtet e parapara në kontratë, për sanimin e kulmit të ndërtesës ku gjatë ekzekutimit të kontratës ka kryer punë tjera, e jo ato sikur në pozicionet 2.2, 2.3, 5.1.5.13 dhe 5.14, të kontratës së lartcekur, ku ditën kritike për shkak të kushteve atmosferike nga ndikimi i erës një pjesë e kulmit të ndërtesës së Komunës së Re bie në tokë, në pjesën e rrugës, trotuarit dhe objektit përreth, duke lënduar rëndë të dëmtuarën E.U, në këtë mënyrë është dëmtuar buxheti i Republikës së Kosovës në shumën prej 36,450.29 euro dhe janë shkaktuar dëme materiale në pesë veturat e parkuara për rreth ndërtesës, me çka ka kryer veprën penale Punimet të Kundërligjshme".

Në Deçan mbahet tribunë me temën "Burgologjia në atdheun e robëruar, gruaja sakrificë e kohës"

EPOKA E RE Qendresa RAMA

DEÇAN, 20 JANAR - Në Deçan nga një grup i grave ish-të burgosura politike gjatë vitit 1981 e tutje është mbajtur një tribunë me temën "Burgologjia në atdheun e robëruar, gruaja sakrificë e kohës". Ky tubim i rëndësishëm është mbajtur në Qendrën Rinore "Fetnete Ramosaj" në Deçan në përkujdesjen e kryetarit të komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj.

Një prej grave të burgosura të komunës së Deçanit që përmendet për sakrificat e saj gjatë periudhës së vitit 1981 është Drita Kuçi nga Juniku, e cila ishte burgosur si pjesëtare e organizatës së quajtur Lëvizja Nacional Çlirimtare e Kosovës dhe Viseve të Tjera Shqiptare nën Jugosllavi (LNÇKVSHJ). Gratë e tubuara nga të gjitha rajonet e Kosovës në Deçan, në



Qendrën Rinore "Fetnete Ramosaj", përmes kumtesave të tyre dhe evokimit të kujtimeve për kohët e vështira që sollën lirinë, i dhanë një kuptim të plotë temës së kësaj tribune: "Burgologjia në atdheun e robëruar, gruaja sakrificë e kohës". Në këtë tribunë gratë që ishin të burgosura në vitin 1981 e më tutje, shkëputën çaste të

rëndësishme nga jeta ilegale dhe nga vuajtjet e dënimeve nëpër kazamatet serbe. Disa prej të burgosurave politike të komunës së Deçanit që ishin të pranishme në këtë manifestim ishin edhe Hatmone Haradinaj, Shqipe Haradinaj, Zyrafete Berisha-Lushaj, Xhejlone Gjokokaj-Haradinaj, Zejnije Lokaj-Mehmetaj dhe Nuriye Cacaj.



Hatmone Haradinaj në kumtesën e saj përfshiu aktivitetin e femrave të burgosura gjatë atyre viteve. Sigurisht se kjo shtresë është një nga shtyllat e fuqishme të atdheut tonë. Sakrificat e kësaj shtrese të shoqërisë sonë padyshim që është gurthemel i lirisë dhe pavarësisë së vendit tonë. Këto femra i gjejmë në organizime që nga viti 1981 e

këndej, në protesta, në demonstrata, në organizime ilegale, në UÇK, në parti politike, në pajtimin e gjaqeve, në kuvende burrash e në beteja të përgjakshme kundër forcave serbe.

Jo pak prej tyre kanë rënë në fushëbeteja dhe sot mbajnë titullin heroina të Kosovës, siç janë Xheve Lladrovci, Fetnete Ramosaj, Myrvete Maksutaj, Nana e UÇK-së Aze Brahimaj, Fatime Hetemit, Hyrë Emini e shumë të tjera.

Në shenjë nderimi dhe respekti për sakrificat e mëdha që bënë këto ish-të burgosura politike, kryetari i komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, u dha mirënjohje këtyre grave. Tubimi u organizua nga Nuriye Cacaj, Zyrafete Berisha-Lushaj dhe Zejnije Lokaj-Mehmetaj. Ky aktivitet do të vazhdojë edhe nëpër komuna të tjera të Kosovës.

Nënshkruhet marrëveshja prej 35 milionë eurosh për ndërtimin e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza në Podujevë

PODUJEVË, 20 JANAR - Kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka nënshkruar marrëveshje me drejtorin e BERZh-it në Kosovë, Sergiy Maslichenko dhe kryeshefin e KRU Prishtina, Arsim Fetahu, për ndërtimin e impiantit të ujërave të zeza.

Vlera e këtij projekti është 35 milionë euro. 25 milionë janë kredi nga BERZh-i (kthimin e mjeteve e bën Qeveria e Kosovës), kurse 10 milionë të tjerë sigurohen nga Korniza

Investive e Bashkimit Evropian për Ballkanin Perëndimor. Kryetari Bulliqi e vlerësoi ditë të rëndësishme për komunën e Podujevës nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje. "Me ndërtimin e këtij impiantit jo vetëm që do t'i trajtojmë ujërat e zeza sipas standardeve bashkëkohore, por edhe do të kontribuojmë për shkurtimin e ndotjes së lumenjve dhe mbrojtjen e burimeve ujore", tha Bulliqi.

Projekti realizohet në bashkëpunim me Qeverinë e

Kosovës, Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh) dhe Kompaninë Rajonale të Ujësjellësit "Prishtina".

Në ceremoninë e nënshkrimit të marrëveshjes të pranishëm ishin kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ministri i Financave, Hekuran Murati, zëvendësministri i Ekonomisë, Getoar Mjeku, drejtori i BERZh-it në Kosovë, Sergiy Maslichenko dhe kryeshefi i KRU "Prishtina", Arsim Fetahu.



Mbahet trajnimi mbi psikologjinë e të mbijetuarave të dhunës me bazë gjinore

PRISHTINË, 20 JANAR - Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) ka njoftuar për trajnimin që është mbajtur nga Donika Shahini-Lami, psikologe klinike, e cila ka ndarë përvojat dhe njohuritë mbi qasjen psikologjike ndaj viktimave të dhunës. Ajo ka theksuar rëndësinë e ndjeshmërisë dhe mirëkuptimit në trajtimin e tyre, duke ofruar praktika konkrete dhe teknika mbështetëse për lehtësimin e procesit të shërimit.

Pjesëmarrësit/et diskutuan mbi sfidat dhe praktikat më të mira në raportimin dhe mbështetjen e viktimave. Ata ndanë përvoja nga fusha dhe shkëmbyen njohuri dhe aftësi profesionale.

Erbolina Dinarama, drejtoreshë e Shtëpisë së Sigurt në Gjakovë, ka paraqitur në hollësi punën e qendrës. Ajo ka treguar për rastet që pranojnë, mënyrat e raportimit dhe përpjekjet për t'i mbrojtur viktimat dhe shmangur rikthimin e

traumave.

Përmes shembujve praktikë, Dinarama ndau qasjet që përdorin për të krijuar një mjedis të sigurt dhe mbështetës për gratë dhe vajzat.

Ky aktivitet është pjesë e projektit në bashkëpunim me UN Women Kosovo, "Adresimi i ndikimeve të dhunës me bazë gjinore në Kosovë dhe fuqizimi i të mbijetuarve për të luftuar stigmën dhe për të folur hapur", mbështetur nga British Embassy Pristina.



Kardiokirurgjia shënon numër rekord të operimeve në zemër të hapur

PRISHTINË, 20 JANAR - Shërbimi Klinik i Kardiokirurgjisë gjatë vitit 2024 ka shënuar numër rekord të ndërhyrjeve në zemër të hapur. Falë rinovimeve që kanë ndodhur po në këtë njësi janë krijuar mundësitë që të rritet edhe numri i operacioneve më të komplikuar për pacientët. Përmirësimet infrastrukturore që kanë ndodhur vitin e kaluar kanë rritur numrin e shtretërve në njësinë intensive, por edhe në gjithë klinikën, thotë drejtori i Kardiokirurgjisë, Shpejtim Shurdhiqi. "Ka qenë një vit jashtëzakonisht i suksesshëm për shërbimin klinik të kardiokirurgjisë. Gjatë vitit 2024 kemi arritur që të bëhet një rinovim i klinikës në tërësi e cila ka krijuar një hapësirë të mirë për të gjithë stafin, posaçërisht për pacientët. Ajo që është me rëndësi është arritur që të rritet numri i shtretërve në



intensivë, është rritur numri nga 4 në 10 shtretër, ndërsa në repart është rritur numri prej 14 në 17. Kështu që kjo hapësirë e rritur, rinovimet e pjesës së nënkulmit, kanë bërë që të kemi një aktivitet më të shtuar të ndërhyrjeve kirurgjike në repartin tonë.

Kemi arritur që ky numër i operacioneve të rritet ndjeshëm. Përderisa më herët janë realizuar 6-7 operacione brenda javës, tash kemi arritur që ky numër të arrijë në 10, shto edhe rastet urgjente apo emergjente të cilat kryhen

gjatë tërë javës. Kjo ka ndikuar në masë të madhe që të kemi gradualisht edhe zvogëlim të listës së pritjes, e cila mendoj se në të ardhmen do të reduktohet edhe më tutje", thotë Shurdhiqi. E numër rekord të operimeve kjo njësi ka shënuar vitin e

kaluar. "Vitin e kaluar është një numër rekord i operimeve gjatë historisë së kardiokirurgjisë. Deri në fund të dhjetorit kemi arritur të kryejmë 372 intervenime kirurgjike në zemër të hapur. Kjo, siç thashë, ka ndikuar që edhe lista e pritjes lehtësisht të arrihet dhe të zvogëlohet", ka theksuar kardiokirurgu Shurdhiqi.

Në Kardiokirurgji, duke nisur nga viti i kaluar, është rritur edhe numri i operimeve të komplikuar në zemër të hapur.

Drejtori i kësaj njësie, Shpejtim Shurdhiqi, thotë se planifikojnë që në periudhën dy deri trevjeçare të realizohen më shumë ndërhyrje me metoda minimale invazive.

Shërbimi i Kardiokirurgjisë po planifikon që përgjatë këtij viti të pasurohet edhe me pajisje të reja. (Ksp)

Universiteti i Prishtinës zgjeron bashkëpunimet

PRISHTINË, 20 JANAR - Rektori i Universitetit të Prishtinës, Arben Hajrullahu, në një takim me Anna Y. C. Ho, zëvendësdrejtoreshë e zyrës përfaqësuese të Taipeiit në Hungari, tha se bashkëpunimi në mes të Universitetit të Prishtinës dhe universiteteve të Tajvanit do të jetë i shkëlqyeshëm. Universiteti i Prishtinës dhe Universiteti Nacional i Tajvanit në janar të 2025-s nënshkruan marrëveshjen për shkëmbim studentësh. Anna Y. C. Ho e konsideroi këtë universitet ndër më të mirët në vendin e saj. "Gjithçka nis me hapin e parë", tha rektori Hajrullahu, duke kërkuar të shkohet edhe

një hap më tutje e të kërkohen rrugë bashkëpunimi edhe për lidhjen e universiteteve me tregun e punës dhe bizneset. Në takim u fol edhe për mundësitë e studimeve në këtë vend aziatik dhe për bursat që universitetet nga Tajvani u ofrojnë studentëve të Kosovës dhe shteteve të tjera të rajonit. Bashkëbiseduesit u pajtuan që kontaktet mes personelit akademik e studentëve kosovarë e tajvanezë mund të shtohen e fuqizohen edhe nëpërmjet pjesëmarrjes në ligjëratat dhe aktivitetet e Universitetit Veror të Prishtinës që në vitin 2025 do ta ketë edicionin e tij jubilar të 25-të.



Hamza takon Gucatin, ia uron detyrën në krye të OVLUÇK-së

PRISHTINË, 20 JANAR - Kandidati për kryeministër i PDK-së, Bedri Hamza, ka vizituar Organizatën e Veteranëve të Luftës së UÇK-së për t'i uruar

për zgjedhjet e tyre dhe për t'i ofruar kryetarit të rizgjedhur, Hysni Gucati, mbështetjen e nevojshme. "Kategoritë e dala nga lufta do ta kenë

gjithmonë mbështetjen time dhe për 50% do ta rrisim përkrahjen financiare për familjet e dëshmorëve, invalidët e luftës dhe

veteranët e UÇK-së. Kosova mundet ma mirë! Ne besojmë në këtë dhe do ta bëjmë realitet!", ka shkruar Hamza në "Facebook".



A po keqpërdoren punëtorët e Bangladeshit nga kompanitë në Kosovë?

PRISHTINË, 20 JANAR - Një kërkesë jo shumë e zakonshme i erdhi Kosovës nga Bangladeshi. Ky vend aziatik kërkoi të bëhet punësimi i qytetarëve të saj në shtetin më të ri në Evropë. Megjithatë, që disa vjet qytetarët nga Bangladeshi janë duke punuar në kompani të ndryshme private në vend. Por sipas kryetarit të Sindikatës së Sektorit Privat, Jusuf Azemi, këta punëtorë janë duke punuar në kushte jo të mira. "Janë duke u keqpërdorur jashtëzakonisht shumë. Ata punojnë për një pagë shumë të ulët, 350-400

euro, për punët që konsiderohen më të rënda në Kosovë. Pra janë duke punuar në kushte tmerrësisht të rënda. Unë i kam vizituar dhe kam parë se në një dhomë prej 16 metrave kanë qenë rreth 11 punëtorë të stacionuar. Aty ziejnë, hanë ushqim, kryejnë pastrim. Është një tmerr i madh", ka thënë Azemi. E numri i punëtorëve që vijnë nga Bangladeshi, sipas Azemit, shkon mbi 1 000. "Tmerrri më i madh është se ata punojnë punë shumë të rëndë, bile punojnë edhe punë shumë të rrezikshme. A është produktive kjo? Nuk

është, sepse shumica prej tyre nuk dinë të komunikojnë me pronarët e kompanive dhe, në fakt, shpeshherë këta punëtorë nuk mund të japin atë që duhet te pronari i kompanisë për shkak të gjuhës. Kemi informacione se rreth 1 000 punëtorë janë të këtij lloji", thotë Azemi për tëvë1.

Por sipas kryetarit të Odës Ekonomike të Kosovës, Lulëzim Rafunës, Kosova nuk është destinacioni i fundit i këtyre punëtorëve. "Kjo nuk ka paraqitur një zgjidhje të përhershme të biznesit, për arsye se ardhja e tyre nuk i ka



krijuar biznesit komoditet. Këta më shumë e kanë shfrytëzuar Kosovën si trampolinë për të punuar deri në gjetjen e një mundësie për të dalë në BE", ka shprehur

Rafuna. Sipas një raporti të publikuar nga Instituti Gap, në vitin 2023 mbi 3 000 leje të punës janë lëshuar nga shteti i Kosovës për shtetasit e huaj.

Kompania teknologjike amerikano-finlandeze "Wolt" arrin në Kosovë: Një revolucion në shpërndarjen e ushqimit dhe produkteve

PRISHTINË, 20 JANAR - Kosova po tërheq kompani të huaja dhe gjigandi global i teknologjisë "Wolt" është marka e njohur amerikano-finlandeze që ka vendosur ta përfshijë këtë vend në hartën e saj të veprimtimit.

Ngjyrat karakteristike bardhë dhe blu të "Wolt" do të bëhen së shpejti pjesë e tregut të Kosovës, duke sjellë risi në transformimin e mënyrës së shpërndarjes së ushqimit dhe produkteve të ndryshme. Me ardhjen e shumëpritur të saj, "Wolt" synon ta lehtësojë jetën e kosovarëve, duke e bërë më të shpejtë dhe më të lehtë qasjen në ushqimet dhe produktet e tyre të preferuara kudo ato ndodhen.

"Wolt", një lider në teknologji dhe tregti lokale me bazë në Helsink, është e përkushtuar për ta përmirësuar jetën urbane për klientët, bizneset dhe shpërndarësit. E njohur për platformën e saj të lehtë për t'u përdorur nga telefoni, "Wolt" shkon përtej thjeshtësisë të porositjeve - ajo fuqizon bizneset lokale me mundësi të reja rritjeje dhe u ofron shpërndarësve partneritete fitimprurëse dhe fleksibilitet të madh. Mjetet e avancuara të kompanisë, përfshirë optimizimin e dorëzimit në kohë, softuerin për tregtarët dhe përparësitë financiare, reflektojnë përkushtimin e saj për të krijuar një ekosistem modern dhe të integruar, raporton "Telegrafi".



Në vitin 2022 "Wolt" bashkoi forcat me "DoorDash", kompaninë kryesore me bazë në ShBA në të njëjtin sektor. Ky bashkim ka zgjeruar shtrirjen e "Wolt", duke i mundësuar asaj të menaxhojë operacione në 29 tregje ndërkombëtare jashtë ShBA-së. Ky bashkëpunim kombinon pikat e forta të të dy kompanive për të ofruar një platformë të jashtëzakonshme për tregtarët, klientët dhe shpërndarësit në tregjet

ekzistuese dhe ato të reja.

Ardhja e "Wolt" në Kosovë shënon një çast historik në udhëtimin global të saj, duke sjellë një standard të ri shërbimi në tregun lokal të Kosovës. Me aplikacionin e saj intuitiv, kosovarët mund të porosisin online pa mundim nga një gamë e gjerë restorantesh dhe bizneseve lokale e ndërkombëtare, duke e kthyer telefonin e tyre të mençur në një qendër virtuale tregtare.

Ngjyrat ikonike bardhë dhe blu të "Wolt" janë më shumë sesa një markë; ato përfaqësojnë një mision për ta ngritur nivelin e shpërndarjes së ushqimit dhe produkteve, duke forcuar lidhjet mes klientëve dhe bizneseve në mbarë Kosovën.

Strategjia e "Wolt" për hyrjen në Kosovë bazohet në bashkëpunim të drejtpërdrejtë. Kompania do të punojë ngushtë me bizneset lokale, partnerët e shpërndarjes dhe klientët për të krijuar një

përvojë të përshtatur sipas nevojave të komunitetit. Kjo qasje e menduar mirë premtan një integrim të qetë në tregun kosovar, duke garantuar një ndikim pozitiv për të gjithë aktorët e përfshirë.

Si platforma e parë globale për shpërndarjen e ushqimit që operon në Kosovë, "Wolt" sjell mundësi të reja për klientët, tregtarët dhe shpërndarësit. Partneriteti i saj me "DoorDash" thekson një përkushtim të përbashkët për ta revolucionarizuar tregtinë lokale dhe për të ofruar shërbime më të mira në të gjitha tregjet e saj.

Me një rrjet prej mbi 170 000 vende aktive globalisht dhe 260 000 partnerë të shpërndarjes, "Wolt" është e përkushtuar për t'i ndihmuar restorantet ta zgjerojnë shtrirjen e tyre dhe t'i optimizojnë shërbimet e shpërndarjes. Për klientët ajo ofron një platformë të nivelit botëror që e bën të ngrënit më të shpejtë, më të thjeshtë dhe më të këndshëm.

Në vitin 2024 "Wolt" zgjeroi praninë e saj në Shqipëri, duke forcuar më tej pozicionin në rajon. Me mbi 45 milionë përdorues të regjistruar globalisht dhe një fuqi punëtore prej më shumë se 13 000 punonjësish, ardhja e "Wolt" në Kosovë e konsolidon statusin e saj si lider në industrinë e shpërndarjes së ushqimit, e gatshme për të formësuar një epokë të re lehtësie dhe inovacioni për vendin.

Biznesmeni klinas vodhi mbi 16 500 euro rrymë

PRISHTINË, 20 JANAR - KEDS-i ka njoftuar se një nga tri bizneset në varg në Klinë, me pronar të njëjtë, që disa kohë po vidhte rrymën. "Në fabrikën e tij të letrës dhe

plastikës, pronari kishte anashkaluar njehsorin elektrik duke instaluar një njehsor që nuk figuronte fare i regjistruar në sistem të KEDS-it. Ai kishte lidhur katër

elektromotorë në të zezën, duke i shkaktuar dëme kompanisë. E për këtë detyrohet t'ia kompensojë KEDS-it 16,502.49 euro në kuadër të rikthimit të

humbjeve. Ky biznes do të ballafaqohet edhe me një proces gjyqësor, ku mund të dënohet me gjobë ose me burg ose me të dyja bashkë", ka njoftuar KEDS-i.



FJALIM NË "AKADEMINË E FLAKËS" NË GJILAN

NËNË STANA, NËNË TEREZA E USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS



Ismet SYLEJMANI

Shumë e dashura dhe shumë e nderuara Nënë Stana e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës!

I nderuar Kryetar i Gjilanit Alban Hyseni, e nderuara nenkryetare e Gjilanit znj. Bunjaku, i nderuar Drejtor i Kulturës Kushtrim Zeqiri,

Të dashur bashkëluftëtar e shokë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Filip, Fatmir dhe Viktor Gashi!

Të nderuara vajza dhe djem tjerë, familjarë e miq, ngado që keni ardhur, të Nënë Stanës!

E dashura Mikja ime dhe e shumë atdhetarëve e patriotëve nga Gjilani e nga Kosova, vajza e Heroit të Popullit Bardhok Biba, e nderuara Marie Biba, mirë se ke ardhur në Gjilanin lirinashës!

Të nderuara familje të dëshmorëve e invalid të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës!

I nderuar Komandant e zv. Komandant i Zonës Operative të Karadakut të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës Ahmet Isufi e Shemi Syla!

I nderuar Komandant i FSK-së, Të nderuar ish-të burgosur politik, atdhetar e veteranë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të UÇPMB-së e të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare! Të nderuar priftërinj të Kishës Katolike shqiptare Dom Shtjefën dhe Dom Frrok, Te nderuara Motra të Nderit të Kishës Katolike Shqiptare, Të nderuar të pranishëm! Zonja dhe zotrinj!

E dashura Nëna Stanë,

Këtu në këtë sallë, të mbushur përplot, në numër shumë të madh, janë ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që kanë ardhur gjatë luftës në shtëpinë Tende në Peshter të Brusit, e të cilët, Ti i ke pritur dhe ju ke uruar mirëseardhje, ju ke gatuar buk dhe jau ke shtruar sofren, me formulën e famshme shqiptare, shtëpia është e mysafirit dhe e zotit, me buk, krip e zemer!

Nëna Stanë,

Dalja Jote, më 11 Janar 2025, me aq madhështi triumfale të Nënës shqiptare katolike, e ka bazën e të qenurit Nënë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës!

Nëna Stanë,

Ti me atë hap krenarie dhe ballë lartë, me atë hap shekujsh, hapëroje si Ajkunë, me nga një lule të kuqe në dorë, varr më varr, duke i nderuar luftëtarët e lirisë, ushtarët e lavdishëm të

Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Dëshmorët e Kombit, ata të cilët ishin ushqyer nga duart tua të arta: të pavdekshmit Pajazit Ahmeti, Muharrem Ibrahim, Bahtir Jahiri, Enver Miftari dhe Fadil Jakupi!

Nëna Stanë,

për luftëtarët e lirisë, ushtarë në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, Ti je Nënë shpirti, Ti je Nënë zemre, Ti je Nënë buke, Ti je Nënë lufte, Ti je Nënë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, por e tillë na u duke edhe kur e ndeze Flakadanin e Flakës së Janarit në ballkonin e Teatrit të Qytetit në Gjilan!

E dashur Nëna Stanë,

a e sheh, a po bindesh, se nuk të ka përcaktuar rastësisht Kryetari i Komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, me ta kushtuar Akademinë Qendrore të Flakës së 17 Janarit 2025!

Fort i nderuar dhe i dashur Kryetar i Gjilanit Alban Hyseni, në cilësinë e ish-ushtarit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe të ish-Zëdhënësit të Zonës Operative të Karadakut, gjej rastin publikisht të të falenderoj dhe të shpreh mirënjohjen time të madhe për këtë nder të madh që ia ke bërë Nënë Stanës!

Të nderuar të pranishëm,

Faleminderit stërgjyshërve tanë, që duke mos e braktisur fenë e të parëve, nuk janë shpërngulur nga Brusit!

Ata duke jetuar në maja të bjeshkëve kreshnike shqiptare, në lartësitë mbidetare mbi 950 metra ashtu sikur është Lagjja Peshter, na u bë e mundur që gjatë luftës, ta kishim një nga bazat e fuqishme të shtëpive bazë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, atë fortesë natyrale shqiptare, ku e kishte piketuar edhe më herët strategu ynë i madh kombëtar, Komandanti i lavdishëm i Partisë të Luftës së Kosovës, Heroi i Kombit Rexhep Malaj!

Të nderuar të pranishëm,

Nëna Stanë, edhe i ka pasur djemt ushtar, edhe ju ka dhënë buk ushtarëve të UÇK-së, pra Nëna Stanë, bënë pjesë në mesin e Nënave të mëdha, e cila edhe me bashkëshortin e saj Bacën Nua, edhe me djemt e vajzat, me nipat e mbesat edhe me shtëpinë, të gjitha i kishte vënë në funksion e në shërbim të luftës!

Nënës Stanë,

Ja kanë sjellur në shtëpi luftëtarët e lirisë, djemt e saj, por edhe nga shtëpia me siguri maksimale, ia kanë tërënjekur dhe kështu me hyrje e dalje, më përcjellje dhe me disiplinë të hekurt ushtarake, ka funksionuar koridori i famshëm i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Zhegoc-Verbicë-Brus dhe Brus-



Mramor-Marec e anasjelltas!

Në kohë luftërash e bllokadash, armiqtë dhe tradhtarët dëshirojnë të të lënë edhe pa buk, dhe Ti Nënëmadhe, duke e ditur se buka në kohë lufte është si fisheku, nuk lejove që bijtë e popullit, ushtarë të UÇK-së, të ishin pa bukë e të pangrenë!

Nëna Stanë,

Bukëdhënsja historike e ushtarëve dhe ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, do të mbetet një nga Nënave e mëdha të Kombit, e cila në historinë luftarake e çlirimtare të popullit shqiptar të Kosovës, do të radhitet përkrah nënave të lavdishme, që për Atdheun dhanë e bënë gjithçka, që Ai të jetë i lirë dhe i pavarur nga Serbia pushtuese!

Nëna Stanë,

Të gjithë duhet ta dinë se Ti dhe fëmijët tuaj në familjen Tende, gjatë kohës së luftës, keni mbushur ujë në krua, 500 metra larg shtëpisë, të cilin me enë të ndryshme, ne duar e krah dhe e keni bartur edhe të ngarkaur në kali dhe ju keni dhënë të pijne ujë ushtarët e UÇK-së, pastaj me atë ujë keni zier gjellra të ndryshme për tua shtruar sofren me bukë, çlirimtarëve të Atdheut!

Të nderuar të pranishëm, Ushtria Çlirimtare e Kosovës, e cila edhe falë angazhimit të familjes Tënde e dashura Nëna Stanë, sikur edhe e pjestarëve tjerë të familjeve shqiptare katolike në të gjitha pjesët e Kosovës, shpartalloi

me sukses platformën maltusiane dhe përçarëse të Akademisë serbe dhe të kryexhelatit Milosheviq, për të na shkatërruar në baza fetare dhe etiketimin e ushtrisë tonë çlirimtare si fundamentaliste islamike, pra kanë dështuar me turp dhe do të dështojnë kurdoherë, sepse Kosova as nuk ka qenë e as nuk do të jetë kurrë fundamentaliste islamike e antiamerikane dhe anteuropiane, ashtu siç dëshiron ta paraqesë propaganda armiqsore serbe dhe aleatet e saj, sepse shqiptarët e ardhshëm, do të dinë ta drejtojnë drejtë e saktë shtetin tonë të ri Kosovën, në integritime euroatlantike, prandaj fuqishëm e themi se UÇK, ishte akti madhor dhe projekti fitimtar i përmbylljes me sukses, të përpjekjeve shekullore kundër Serbisë pushtuese e tradhëtarëve, e cila me ndihmën ushtarake të aletës tonë të madhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe NATO-s, u bë çlirimtarja përfundimtare e tokës tonë të pushtuar!

E dashura Nëna Stana!

Faleminderit përgjithëçka që kë bërë në luftën për çlirimin e Kosovës nga zgjedha pushtuese serbe!

Uroj e lutëm, që zoti të të jep jetë e lumturi në familjen Tënde të madhe, lirinashës e çlirimtare! Shteti i Kosovës në veçanti, dhe kombi shqiptar në përgjithësi, nderimet për Ty, nuk do t'i ndalë kurrë!

Ta kemi borgj Nënë!

E kemi obligim Nënë!

Nëna Stanë,

Ti je Nënë e madhe shqiptare katolike, Ti je njëra nga motrat e të famshmes Nëna Terezë. Ti Nënë Stanë, je Nëna Terezë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës!

Jetë të gjatë e të lumtur Nëna Stanë!

Të ruajtë zoti Nënë!

Gjilan, 17 Janar 2025!



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Kuka: Lojërat Olimpike, vendi ku tregohen vlerat e shtetit në sport

Trajneri i xhudos, Driton Kuka, padyshim është trajneri më i mirë që e ka pasur ndonjëherë Kosova. Kuka numëron pesë medalje olimpike me garueset e tij, të cilat i fitoi në tri Olimpiada, në atë qe sa mori pjesë Kosova që

nga ndërkombëtarisht. Tash sytë e trajnerit numërojnë një shqiptar janë nga Lojërat e radhës Olimpike që do të mbahen në Los Anxhelos të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në vitin 2028. “Rrugëtimi

vazhdon. Londër 2012-Rio 2016-Tokio 2020-Paris 2024, misioni i radhës LA 2028! Lojërat Olimpike, vendi ku tregohen vlerat e shtetit në sport! Xhudo do të vazhdojë tutje, gjithmonë! Gjenerata të reja po rriten e kaliten!”, ka

shkruar Kuka. Distria Krasniqi i ka fituar dy medalje olimpike, një të artë dhe një të argjendtë, Majlinda Kelmendi e Nora Gjakova e kanë fituar nga një të artë, kurse Laura Fazliu e ka fituar të bronzën.



Kryeziu dhe Rashkaj emërohen ndihmëstrajnerë në ekipet e përfaqësuesve U21 e U19

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 20 JANAR - Ish-futbollistët e dëshmuar të Përfaqësueses së Kosovës në futboll kanë marrë pozita të rëndësishme në përfaqësueset e reja të “dardanëve”.

Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, ka takuar dyshen në fjalë dhe i ka informuar për arritjet dhe projektet e realizuara nga FFK-ja, si dhe për reformat e vazhdueshme që po zbatohen me qëllim të përmirësimit të organizimit të federatës dhe krijimit të kushteve më të mira infrastrukturore për futbollin në vendin tonë.

Në kuadër të këtyre reformave, presidenti Ademi ka marrë vendim që Hekuran Kryeziu të emërohet në pozitën e ndihmëstrajnerit të Përfaqësuesja U21, ndërsa Anel Rashkaj të emërohet ndihmëstrajner të Përfaqësuesja U19. Përveç angazhimit në Përfaqësuesen U19, Rashkaj do të jetë pjesë e Departamentit Teknik të FFK-së, duke kontribuar me përvojën dhe njohuritë e tij në zhvillimin e futbollit të Kosovës. “Hekurani dhe Aneli kanë dhënë shumë për Kombëtaren tonë si lojtarë dhe tani është koha që ata të vazhdojnë të kontribuojnë në një rol të ri. Jam i bindur që përvoja e tyre



do të jetë një aset i çmuar për të rinjtë tanë dhe zhvillimin e ekipeve tona zinxhirë të kombëtares”, ka thënë Ademi. Ndërsa Anel Rashkaj është shprehur shumë i lumtur dhe shumë krenar që përsëri është pjesë e FFK-së, tani në një aspekt tjetër, si trajner. “Pas përvojës shumëvjeçare si futbollist në elitën e futbollit në Skandinavi dhe sidomos si lojtar i Kombëtares së Kosovës nga viti 2008, pas rrugëtimit të gjatë që kemi pasur, të rikthehem sërish është një kënaqësi e madhe. Mendoj dhe shpresoj që do ta jap kontributin tim nga përvoja

ime e gjatë si lojtar, por edhe në aspektin menaxherial që kam. E di saktësisht se në çfarë duhet të fokusohemi dhe do ta jap maksimumin tim”, ka thënë Rashkaj. Ndërsa Hekuran Kryeziu i ka falënderuar të gjithë për mundësinë që sërish të jetë pjesë e Federatës së Futbollit. “Unë do të jem ndihmëstrajner i Kombëtares U21 të Kosovës dhe shikoj përpara për një bashkëpunim të jashtëzakonshëm me trajnerin legjendar të Kosovës, Afrim Tovërlani. Mezi po pres të nis këtë projekt”, ka deklaruar Kryeziu.

SHKURT

Bunjaku, MVP i javës në Superligën e basketbollit

ProCredit Superliga po vazhdon të dhurojë sfida interesante. Bashkimi fitoi derbin prizrenas ndaj Proton Cable Prizrenit, ku u dallua organizatori vendor Valon Bunjaku me 27 pikë, një kërcim dhe katër asistime. Bunjaku kishte indeksin 32 apo më të lartën në këtë xhiro, duke u shpallur MVP i javës së 17. Ai u ndihmua nga Jayveous Mckinnis, i cili kishte shtatë pikë, por edhe 18 kërcime e tri asistime, duke hyrë në Top 5 të kësaj xhiroje. Peja fitoi ndaj Borës, duke regjistruar fitore të rëndësishme, ku më i dalluari ishte Tristan Ikpe me 22 pikë, 13 kërcime dhe dy asistime. Vëllaznimi po vazhdon në formë të lartë, ku shënoi pesë fitore në gjashtë ndeshjet e fundit në elitë. Kuqezinjtë fituan ndaj Trepçës në Mitrovicë, ku më i miri ishte Jericole Hellems me 23 pikë, nëntë kërcime dhe dy asistime. Ndeshja e baraspeshuar u zhvillua për 38 minuta ndërmjet Golden Eagle Yllit dhe Sigal Prishtinës, ku më i dalluari te prishtinasit ishte Daniel Lekndreaj me tetë pikë, 13 kërcime dhe dy asistime.

Ademi priti talentet e përzgjedhur nga Barcelona

Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, e ka nisur javën me një takim të veçantë dhe inspirues me tre futbollistë të rinj nga Kosova që janë përzgjedhur në “Barça Camp Kosova” për ta vazhduar rrugëtimit e tyre drejt klubit të famshëm FC Barcelona. Të përzgjedhurit e këtij kampi, Olti Jashari (8 vjeç), Bora Bajrami (16 vjeç) dhe Oldion Kiqina (14 vjeç), u pritën në një atmosferë të ngrohtë në selinë e FFK-së. Gjatë bashkëbisedimit, presidenti Ademi i përgëzoi për suksesin e tyre dhe i inkurajoi të vazhdojnë ta ndjekin pasionin e tyre dhe të punojnë me përkushtim. “Kjo është një mundësi e madhe dhe një hap i rëndësishëm në zhvillimin tuaj si futbollistë. FFK do të jetë gjithmonë pranë jush, duke ju mbështetur në çdo hap të rrugëtimit tuaj”, ka thënë kreu i FFK-së. Talentet e reja shprehën vendosmërinë për t’i realizuar ëndrrat e tyre në një prej akademive më prestigjioze të futbollit në botë. Presidenti Ademi, gjithashtu, theksoi se ky është një tregues i qartë i potencialit që futbollit i Kosovës ka për të ofruar, duke shprehur krenari për të arriturat e të rinjve tanë. Ai u uroi Oltit, Borës dhe Oldionit suksese të mëtejshme dhe rrugëtim të mbarë.

Shkumbin Maqastena zgjedhet kryetar i Federatës së Gjimnastikës së Kosovës

PRISHTINË, 20 JANAR - Federata e Gjimnastikës së Kosovës mbajti Kuvendin e Punës dhe Kuvendin Zgjedhor për periudhën 2024-2028. Në Kuvendin e Parë të Punës dhe atë Zgjedhor të datës 21 dhjetor, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka gjetur shkelje administrative (votim nga një klub i pacilësuar) dhe rekomandimi i MKRS-së ka

qenë përsëritja e Kuvendit të Punës dhe atij Zgjedhor. Nga zgjedhjet e së dielës, të monitoruara nga Ministria e Sportit dhe Komiteti Olimpik i Kosovës, Federata e Gjimnastikës e Kosovës ka zgjedhur organet e reja drejtuese, ku 28 delegatët përfaqësues nga dhjetë klube të licencuara të gjimnastikës votuan dhe zgjedhën për kryetar

të Federatës së Gjimnastikës së Kosovës, Shkumbin Maqastena. Nënkryetarë të FGJK-së u zgjedhën Sherife Aliqkaj-Qerimi dhe Besim Halilaj, ndërsa anëtarë të bordit të ri të FGJK-së janë: Besnik Latifi, Elfete Gashi, Ard Kryeziu, Rizonë Mustafa, Amir Januzi dhe Lisa Zeqiri. FGJK-ja zgjodhi edhe komisionin Mbikëqyrës dhe të Apelit.



Clippersat fitojnë derbin me lakersat, shkëlqejnë Oklahoma, Miami, Denveri dhe Milwaukee

LOS ANXHELOS, 20 JANAR - Ekipi i Clippersave fitoi rezultat 116-102 ndaj Lakersave në derbin e Los Anxhelosit. Tre lojtarë të Clippersave realizuan mbi 20 pikë (Powell 22 pikë, Zubac e Harden nga 21 pikë secili), duke i bërë të pavlefshme 25 pikët e Jamesit për Lakersat. Kampionët

e Denverit fituan me rezultat 113-100 në fushën e Orlandos, me Jokiqin protagonist, autor i një "triple-double" (20 pikë, 14 rebounde, 10 asistime). Fitoi edhe Miami, 128-107 ndaj San Antonios, sfidë ku 71 pikë erdhën nga lojtarët e stolit. Oklahoma mbetet skuadra më e

mirë në Perëndim, duke fituar me rezultat 127-101 ndaj Brooklynit, ndeshje ku dëshja Shai-Joe realizoi 51 pikë së bashku. Ndërsa ekipi i Milwaukeees, falë 34 pikë e 15 reboundeve të Antetokounmpos, mundi me shifrat 123-109 Philadelphia.

Rezultatet: Miami-San Antonio (128-107), Orlando-Denver (100-113), Milwaukee-Philadelphia (123-109), Oklahoma-Brooklyn (127-101), Clippers-Lakers (116-102), Portland-Chicago (113-102), Sacramento-Washington (123-100).



Alonso: Moshja s'ka rëndësi, dua t'u tregoj tifozëve të rinj se mund të fitoj me një makinë të mirë

OVIEDO, 20 JANAR - Pavarësisht prej moshës, tashmë 43-vjeçar, piloti spanjoll Fernando Alonso beson se mund të dujojë dhe të fitojë sërish në Formula 1. Dy herë kampioni i botës thotë se nuk është kurrë i kënaqur dhe gjithmonë është në kërkim të sfidave të reja. Në një intervistë për "BBC Sport", ai ka trajtuar çështje të ndryshme. "Nuk mendoj shumë për moshën, ndonëse ende ma kujtojnë herë pas here. Ndihej sikur jam 25 ose 30-vjeçar dhe ende konkurroj. Nuk e ndiej moshën time. Jam ende i motivuar, i freskët, i stërvitur për të garuar dhe për të bërë të njëjtën stërvitje që kam bërë 20 vjet më parë, sepse rutina është e njëjtë", ka thënë Fernando Alonso, që piloton një Aston Martin. "Mendoj se kjo varet nga disiplina ime në punë, stërvitje dhe përkushtimi im ndaj Formula 1 që është mjaft ekstrem. Nuk kam munguar kurrë në një seancë testimi ose në një takim me



inxhinierët ose fabrikë. Kjo është kur vërtet duhet t'i përkushtohesh F1 për të pasur një shans për t'i korrur përfitimet më vonë", ka shtuar spanjoli. Më tej, Fernando Alonso ka shtuar: "Kam urinë për sfida të reja sepse nuk kam pasur kurrë një makinë kaq të mirë sa të mund të dominoj. Gjatë gjithë karrierës sime kam pilotuar gjithmonë makina që nuk ishin

më të mirat edhe në vitet e dy titujve të mi kampion bote për pilotë". "Unë mbetem i motivuar sepse çdo vit shpresoj të kem një makinë të shpejtë. E di që po plakem dhe ka mjaft tifozë të rinj që nuk dinë shumë për mua dhe që nuk më kanë parë kurrë të fitoj një garë. Kam shpresë t'u tregoj se e kanë gabim, me një makinë të shpejtë në vitin 2026", ka deklaruar Alonso.

Te Manchester City shpresojnë ende: Titulli është i mundur

MANCHESTER, 20 JANAR - Manchester City arriti një fitore të rëndësishme 6-0 ndaj Ipswichit, që riktheu ekipin e dikurshëm, të pamëshirshëm dhe që dominon në fushë. Rezultat që ka rikthyer besimin te skuadra, çka duket në fjalët e mbrojtësit Manuel Akanji. Ai thotë se fitimi i titullit është ende i mundur për skuadrën e trajnerit Pep Guardiola: "Gjëja më e rëndësishme tani është t'i rikuperojmë të gjithë lojtarët e dëmtuar dhe të luftojmë së bashku për trofetë e sidomos për titullin. Gjithçka varet nga ne. Duhet të tregojmë paraqitje të mira dhe do të fillojmë nga ndeshja e radhës. Ka disa gjëra në të cilat duhet të përmirësohemi. Gjithmonë mund të përmirësoheni në futboll, por mendoj se jemi në rrugën e duhur", ka thënë Akanji.



Në fund, mbrojtësi shpreson që të gjithë të jenë të shëndetshëm: "Uroj të mos kemi më dëmtime të rënda dhe më pas të gjithë të përpiqemi ta japim më të mirën në fushë. Gjithmonë është më e lehtë kur luajmë të gjithë". "Haaland? Jam shumë i lumtur që ai do të qëndrojë këtu për një

kohë të gjatë dhe i lumtur që është në ekipin tim. Ai ka qenë një ndihmë e madhe për ne, ka shënuar kaq shumë gola dhe mban topin për të krijuar mundësi. Ai është sulmuesi më i mirë në botë dhe e ka fituar plotësisht këtë kontratë", ka deklaruar Akanji.

SHKURT

Oliver Kahn: Xhaka ka një mentalitet të fortë

Portieri legjendar i Bayern Munchenit dhe Kombëtares së Gjermanisë, Oliver Kahn, është i impresionuar nga Bayer Leverkuseni dhe Granit Xhaka. 55-vjeçari gjerman është i impresionuar nga këmbëngulja e kampionëve gjermanë dhe mënyra sesi Leverkuseni qëndron në luftë me Bayernin. "Granit Xhaka ka një mentalitet të fortë", ka thënë Kahn pas fitores 3-1 të Leverkusenis në shtëpi kundër Monchengladbachut. "Ka shumë djem si Graniti që marrin përgjegjësi. Ata kanë një bosh shumë të mirë, të gjithë lojtarët drejt të cilëve mund të orientoheni. Në përgjithësi, Leverkuseni tregon cilësi të lartë dhe qetësi në top", ka shtuar Kahn.

Trajneri i Lazios: Cilësitë e Hysajt nuk janë vënë asnjëherë në diskutim

Lazio mori tri pikë të rëndësishme ndaj Veronës. Në këtë takim Elseid Hysaj luajti ndeshjen e tij të parë si titullar me lacialët për këtë sezon, duke zhvilluar një sfidë mjaft të mirë. Për mbrojtësin shqiptar foli trajneri i skuadrës kryeqytetase, Marco Baroni. "Kemi rikuperuar lojtarë të rëndësishëm si Hysaj. Cilësitë e tij nuk janë vënë asnjëherë në diskutim. Ai është një lojtar shumë i mirë, por ka qëndruar jashtë skuadrës për arsye të tjera", ka thënë Baroni. Hysaj në këtë sezon është aktivizuar vetëm në 4 takime në kampionat, pasi në shumicën prej ndeshjeve ka qenë i përjashtuar nga lista.

Tirana zëvendëson Maganin me Shkëmbin

KF Tirana pasi ndërpreu bashkëpunimin me Gugash Maganin, e bëri zyrtar rikthimin në bankinë të Bledi Shkëmbit. Me anë të njoftimit për medie, klubi bardheblu ka bërë publike rikthimin e Shkëmbit. "Bledi Shkëmbi rikthehet në drejtimin e KF Tirana. Klubi beson në vazhdimësinë e projektit të nisur në fillim të sezonit, duke ia besuar drejtimin e skuadrës Bledi Shkëmbit, i cili është njohësi më i mirë i kontingjentit aktual në ekip. KF Tirana i uron suksese trajnerit dhe rikthim sa më të shpejtë të rezultatet e shumëpritura nga komuniteti bardheblu", thuhet në njoftimin e Tiranës.

Ancelotti vendos të largohet nga Real Madridi

Trajneri Carlo Ancelotti ka vendosur që të mos e vazhdojë aventurën te Real Madridi përtej sezonit 2024/25. Kohën e fundit shkaku i stilit të lojës, Ancelotti është kritikuar më së shumti te skuadra madrilene për rezultatet e dobëta. Sipas asaj që raporton radio spanjolle "OndaCero", Ancelotti ka vendosur që të mos e vazhdojë aventurën përtej fundit të këtij sezoni. Kontrata aktuale e teknikut italian skadon në qershorin e vitit 2026, prandaj do të ketë shumë pyetje se kush do të jetë pasuesi i tij. Xabi Alonso aktualisht në krye të Bayer Leverkusenis thuhet se është favoriti sidomos falë punës së jashtëzakonshme që ka bërë në krye të klubit gjerman. Ancelotti u rikthye te Reali në vitin 2021 pas suksesit që kishte në vitin 2014 dhe që atëherë ia doli ta fitonte dy herë Ligën e Kampionëve (2022 dhe 2024). Përpos kësaj, me Madridin – ai fitoi dy tituj të La Ligas, Kupën e Mbretit si dhe Kupën e Botës për klube.

Trajneri Amorim: Jemi Unitedi më i dobët i historisë

Manchester Unitedi nuk po gjen qetësi pasi u mund në "Old Trafford" me shifrat 3-1 përballë Brightonit. Disfata ishte e dhjeta në kampionat

dhe tani "Dajtë" janë më afër zonës së rënies nga kategoria se katër vendet e para. Kjo situatë ka shqetësuar Ruben Amorim, i cili pasoi Ten Hag

për t'i dhënë jetë një skuadre, e cila është në "vdekje" klinike. "Ishim shumë të lehtë për t'u mposhtur prej rivalëve tanë", analizoi pas ndeshjes

situatën teknik portugez, i cili nuk kurseu kritikën për shfaqjen e radhës "horror" të Onanës. "Sigurisht që jemi ekipi më i dobët i historisë së

këtij klubi dhe sa më shpejt që e kuptojmë një fakt të tillë, aq më shpejt mund të dalim nga kjo situatë", ka deklaruar Amorim.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë




www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “LEO-M” Sh.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrB UNIK: 810188426 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “LEO-M” D.O.O. od Prishtina, donelo odluku o prestani rada sa nrB. 810188426 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “LEO-M” L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 810188426 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- “Solar Green Energy” SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330184672.

- Gjon Tuci nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës “Gjergj Fishta” Bishtazhin.

- Egzon Nagavci nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës “Emin Duraku”.

- Edonis Makshana shpall të pavlefshme dëftesat e kl. dhjetë dhe njëmbëdhjetë të shkollës së mesme “Selajdin Mullaabazi Mici” Rahovec.

- Alban Jollaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore klasa IX.

- Valdita Elezaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - Bill shfmu “ Pjeter Budi “ Lubizhd e Hasit.

- Kasum Cocaj shpall te pavlefshme diplomën Q.K. “11 Marsi” Prizren.

- Violeta Morina shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu “ Lidhja e Prizrenit “ Prizren.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



Në mbështetje të nenit 8, nenit 10 nën par. 2.2 dhe nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 01.12.2010, lidhur me nenin 7 të Udhëzimit Administrativ MFPT - Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik i cili është pjesë e Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i cili është i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 31.10.2017, dhe nenit 8 par. 4, nenit 11, nenit 21 nën par. 2.2 dhe nenit 25 të Rregullores Nr. 55/21 për Marrëdhënien e Punës të N.P.L "Përparimi" Sh. A. në Vushtri e miratuar me datë 21.12.2021 nga Bordi i Drejtorëve të N.P.L "Përparimi" Sh. A., e duke u bazuar në vendimin me nr. të protokollit 81/25 të datës 20.01.2025 të Kryeshefit Ekzekutiv, N.P.L "Përparimi" Sh. A, me datë 20.01.2025 shpall:

KONKURS PUBLIK

I. Titulli: Shofer i Kamionit

Numri i ekzekutuesve: 4

Orët e punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar një (1) vit nga të cilat gjashtë (6) muaj do të jenë punë provuese, me mundësi vazhdimi.

Përgatitja profesionale: Preferohet Shkolla e mesme

Përvoja e punës: Preferohet gjashtë (6) muaj

I raporton: Menaxherit të Njësisë për Mbledhjen dhe Transportimin e Mbeturinave

Koeficienti i pagës: 504.18 Euro Bruto

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Kujdeset për mirëmbajtjen e automjetit transportues, larjen, lyerjen, evidentimin e prishjeve etj.
- Drejton dhe mirëmban sipas nevojës edhe automjetet tjera të ndërmarrjes.
- Në fletudhëtim regjistron numrin e kilometrave të kaluara dhe shënimet tjera, të cilat kërkohen.
- Paraqet çdo defekt dhe dëmtim të shkaktuar në automjet dhe bën arsyetimin e shpenzimeve të derivateve dhe kilometrave të kaluara.
- Me rastin e prishjes së automjetit vozitësi është i obliguar të benë ndreqje të vogla, si ndërrimin e gomës, pastrimin e filterit etj, të qëndrojë pranë automjetit në punëtori dhe t'i ndihmojë mekanikut ose gomistit.
- Çdo mëngjes është i obliguar të kontrollojë sasinë e vajit, ujit dhe gjendjen e gomave në automjet.

- Është i obliguar që për prishjet në automjet me kohë të lajmëroi kryepunëtorin e vet drejtpërdrejt.
- Kryen edhe punë tjera sipas urdhrave të Menaxhmentit të Ndërmarrjes.
- Për punën e tij i përgjigjet Menaxherit të Njësisë së Mbledhjes dhe Transportimin e mbeturinave.

Kusht i posaçëm:

- Kategoria C e vozitjes.

Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i N.P.L "Përparimi" Sh. A - Vushtri.;
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (e skanuar);
- Ekstraktin e lindjes; (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohet);
- Dëshmia se ka patentën e shoferit të kategorisë C (e skanuar);
- Certifikatën mbi dënimin penal të lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, se nuk ka dënime penale në evidencën qendrore penale të Republikës së Kosovës (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohet);
- Dëshmitë për përvojën e punës (të skanuara) (nuk është obligative);
- Kopjen e letërnjoftimit (e skanuar);

II. Titulli: Mbledhës i mbeturinave – Punëtor Fizik

Numri i ekzekutuesve: 4

Orët e punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar një (1) vit nga të cilat gjashtë (6) muaj do të jenë punë provuese, me mundësi vazhdimi.

Përgatitja profesionale: Shkolla Fillore

Përvoja e punës: Preferohet një (1) vit

I raporton: Menaxherit të Njësisë të Mbledhjes dhe Transportimit të Mbeturinave

Koeficienti i pagës: 457.87 Euro Bruto

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Kryen të gjitha punët në mbledhjen dhe ngarkimin e mbeturinave.
- Mbledh mbeturina dhe bënë zbrazjen e Kontejnerëve dhe mjeteve tjera për mbeturina apo çesëve nga shfrytëzuesit të shërbimeve në sektorin privat dhe shtetëror.
- Pas zbrazjes së Kontejnerëve dhe mjeteve tjera, është i obliguar t'i kthejë ato në vende të caktuara dhe për të të ketë kujdes.
- Është përgjegjës për kryerjen e punëve në mënyrë efikase dhe kualitative, për sjellje korrekte me qytetarët-shfrytëzuesit e shërbimeve.
- Për punën e tij i përgjigjet Menaxherit të njësisë së Mbledhjes dhe transportimit të mbeturinave.

Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i N.P.L "Përparimi" Sh. A - Vushtri.;
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (e skanuar);
- Ekstraktin e lindjes; (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohet);
- Certifikatën mbi dënimin penal të lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, se nuk ka dënime penale në evidencën qendrore penale të Republikës së Kosovës (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohet);
- Dëshmitë për përvojën e punës (të skanuara) (nuk është obligative);
- Kopjen e letërnjoftimit (e skanuar);

> Kriteret e përgjithshme që duhet t'i plotësojnë të gjithë kandidatët.

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.
- Të ketë zotësi të plotë veprimi.
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare në pajtim me Ligjin për Gjuhët.

> Mënyra e vlerësimit të kandidatëve.

- Testimi me shkrim deri në shtatëdhjetë (70) pikë.
- Intervista me gojë deri në njëzetë (20) pikë
- Jetë përshkrimi (CV) i kandidatit deri në dhjetë (10) pikë.

> Periudha e aplikimit të kandidatëve dhe kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit.

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga dita e publikimit të të njëjtit. Shpallja është e hapur nga data 21.01.2025 deri me datë 04.02.2025 në ora 16:00.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit:

- Verifikimi paraprak i aplikacioneve të kandidatëve më së largu deri me datë 11.02.2025.
- Afati për ankesë nga data 12.02.2025 deri me datë 18.02.2025.
- Periudha e kandidatëve kur do t'i nënshtrohen testit me shkrim, dhe kur do të bëhet vlerësimi i tyre do të jetë më së largu deri me datë 28.02.2025.
- Afati për ankesë nga data 03.03.2025 deri me datë 05.03.2025.
- Periudha e kandidatëve kur do t'i nënshtrohen intervistës me gojë, dhe kur do të bëhet vlerësimi i tyre do të jetë më së largu deri me datë 12.03.2025.
- Afati për ankesë nga data 13.03.2025 deri me datë 17.03.2025.
- Publikimi i rezultateve përfundimtare në lidhje me kandidatin e suksesshëm është më së largu 24.03.2025.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit mund të zgjas apo të jetë më i shkurt, varësisht nga ajo se a është parashtruar ankesë apo jo, dhe varësisht nga puna e komisionit vlerësues, dhe departamentit të personelit. Në të gjitha rastet kur parashtrohet ankesë në çdo fazë të procedurës së rekrutimit, ankesa do të ketë efekt suspensiv, derisa e njëjta të shqyrtohet nga Komisioni i Ankesave.

> Dokumentet që kërkohet para themelimit të marrëdhënies së punës:

- Vërtetimi për zotësinë e plotë të veprimit.
- Certifikatën shëndetësore.

> Mënyra e aplikimit dhe komunikimi me kandidatët

Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim mund ta marrin në Zyrën e Arkivës të N.P.L "Përparimi" Sh. A në qytetin e Vushtrrisë, rr. "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" nr. 82, (ish objekti i TMK-së afër Gjykatës Themelore Mitrovicë - dega në Vushtri) çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00. Departamenti i Personelit duke zbatuar nenin 8 par. 3 të Udhëzimit MFPT-Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, do tu ofrojë sqarime të nevojshme për kandidatët në lidhje me kriteret e konkursit publik, dhe do tu asistoj dhe tu jap udhëzimet e nevojshme për aplikim me anë të adresës elektronike.

Dorëzimi i aplikacionit me gjithë dokumentacionin e kërkuar në këtë shpallje publike duhet të bëhet vetëm me anë të adresës elektronike si në vijim: hrperparimi@gmail.com.

I gjithë komunikimi gjatë procedurave të konkursit publik do të zhvillohet nëpërmjet komunikimit elektronik, dhe secili nga kandidatët do të njoftohet individualisht.

Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.

> Sqarim

Ndërmarrja ka për qëllim të sqarojë çështjen e termeve të përdorura në aspektin gjinor, meqë rast fjalët dhe titujt e njëjtinë përfshijnë edhe gjininë tjetër.

> Përfundim

N.P.L "Përparimi" Sh. A në Vushtri ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, dhe inkurajohen komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuara, dhe gjinia më pak e përfaqësuar që të aplikojnë.



Na osnovu člana 8, člana 10, stava 2.2 i člana 15 Zakona br. 03/L-212 o Radu, objavljenog u Službenom glasniku Republike Kosova dana 01.12.2010. godine, u vezi sa članom 7 Administrativnog uputstva MFPT - br. 01/2024 o Uređivanju postupaka konkursa u javnom sektoru, koji je deo Zakona br. 03/L-212 o Radu, objavljenog u Službenom glasniku Republike Kosova dana 31.10.2017. godine, kao i člana 8, stava 4, člana 11, člana 21, stava 2.2 i člana 25 Pravilnika br. 55/21 o Radnim odnosima J.P.L. "Përparimi" a.d. u Vučitrnu, usvojenog dana 21.12.2021. godine od strane Upravnog odbora J.P.L. "Përparimi" a.d., i na osnovu odluke pod protokolarnim brojem 81/25 od 20.01.2025. godine generalnog direktora, N.P.L. "Përparimi" a.d, dana 20-01.2025. godine objavljuje:

JAVNI KONKURS

Naslov: Vozač kamiona

Broj izvršilaca: 4

Radno vreme: 40 časova nedeljno

Trajanje ugovora: Na određeno vreme od jedne (1) godine, od kojih šest (6) meseci probnog rada, s mogućnošću produženja.

Stručna sprema: Požljan srednjoškolski nivo obrazovanja

Radno iskustvo: Poželjno šest meseci

Izveštava: Menadžeru jedinice za prikupljanje i transport otpada

Koeficijent plate: 504,18 € bruto

Opis radnih zadataka i odgovornosti:

- Brine o održavanju transportnog vozila, pranju, farbanju, evidentiranju kvarova itd.
- Vozi i po potrebi održava i druga vozila preduzeća.
- U putnom nalogu beleži pređene kilometre i druge potrebne podatke.
- Prijavljuje svaki kvar i štetu na vozilu te opravdava troškove goriva i pređenih kilometara.
- U slučaju kvara na vozilu, vozač je obavezan da izvrši manje popravke, poput zamene gume, čišćenja filtera itd., da ostane uz vozilo u radionici i pomogne mehaničaru ili vulkanizeru.
- Svako jutro je obavezan da proveriti količinu ulja, vode i stanje guma na vozilu.
- Obavezan je da na vreme prijavi kvarove na vozilu neposrednom nadzorniku.
- Obavlja i druge zadatke po nalogu menadžmenta preduzeća.

Poseban uslov:

- Vozačka kategorija C

Prijavi se mora priložiti:

- Formular za prijavu J.P.L. "Përparimi" a.d - Vučitrn;
- Dokazi o obrazovnoj kvalifikaciji (skenirano);
- Izvod iz matične knjige rođenih (sertifikati izdati online na platformi e-Kosova biće prihvaćeni);
- Dokaz o vozačkoj dozvoli kategorije C (skenirano);
- Uverenje o nekažnjavosti izdato od strane Sudskog saveta Kosova, da nema krivičnih presuda u centralnoj evidenciji kaznenih dela Republike Kosova (sertifikati izdati online na platformi e-Kosova biće prihvaćeni);
- Dokazi o radnom iskustvu (skenirano) (nije obavezno);
- Kopija lične karte (skenirano).

Naslov: Radnik za prikupljanje otpada – Fizički radnik

Broj izvršilaca: 4

Radno vreme: 40 časova nedeljno

Trajanje ugovora: Na određeno vreme od jedne (1) godine, od kojih šest (6) meseci probnog rada, s mogućnošću produženja.

Stručna sprema: Osnovna škola

Radno iskustvo: Požljan jedan (1) godina

Izveštava: Menadžeru jedinice za prikupljanje i transport otpada

Koeficijent plate: 457,87 € bruto

Opis radnih zadataka i odgovornosti:

- Obavlja sve poslove prikupljanja i utovara otpada.
- Prikuplja otpad i prazni kontejnere i druge posude za otpad ili kese od korisnika usluga u privatnom i javnom sektoru.
- Nakon pražnjenja kontejnera i drugih posuda, obavezan je da ih vrati na predviđena mesta i brine se o njima.
- Odgovoran je za efikasno i kvalitetno obavljanje poslova, korektno ponašanje prema građanima-korisnicima usluga.
- Izveštava menadžera jedinice za prikupljanje i transport otpada.

Prijavi se mora priložiti:

- Formular za prijavu J.P.L. "Përparimi" a.d - Vučitrn;
- Dokazi o obrazovnoj kvalifikaciji (skenirano);
- Izvod iz matične knjige rođenih (sertifikati izdati online na platformi e-Kosova biće prihvaćeni);
- Uverenje o nekažnjavosti izdato od strane Sudskog saveta Kosova, da nema krivičnih presuda u centralnoj evidenciji kaznenih dela Republike Kosova (sertifikati izdati online na platformi e-Kosova biće prihvaćeni);
- Dokazi o radnom iskustvu (skenirano) (nije obavezno);
- Kopija lične karte (skenirano).

Opšti uslovi koje svi kandidati moraju ispunjavati:

- Da bude državljanin Republike Kosova.
- Da ima punu poslovnu sposobnost.
- Da poznaje najmanje jedan od službenih jezika u skladu sa Zakonom o jezicima.

Način ocenjivanja kandidata:

- Pismeni test do sedamdeset (70) bodova.
- Usmeni intervju do dvadeset (20) bodova.
- Životopis (CV) kandidata do deset (10) bodova.

Period prijavljivanja kandidata i okvirni kalendar postupka regrutacije:

Konkurs ostaje otvoren petnaest (15) kalendarskih dana od dana objavljivanja. Konkurs je otvoren od **21.01.2025.** do **04.02.2025.** godine u 16:00 časova.

Okvirni kalendar postupka regrutacije:

- Prethodna provera aplikacija kandidata najkasnije do **11.02.2025.**
- Rok za žalbu od **12.02.2025.** do **18.02.2025.**
- Period testiranja kandidata pismenim testom i ocenjivanja najkasnije do **28.02.2025.**
- Rok za žalbu od **03.03.2025.** do **05.03.2025.**
- Period za usmene intervjuje i ocenjivanje kandidata najkasnije do **12.03.2025.**
- Rok za žalbu od **13.03.2025.** do **17.03.2025.**
- Objavljivanje konačnih rezultata o uspešnom kandidatu najkasnije **24.03.2025.**

Okvirni kalendar postupka regrutacije može biti produžen ili skraćen, u zavisnosti od toga da li je podneta žalba ili ne, kao i od rada ocenjivačkog odbora i odeljenja za kadrove. U svim slučajevima kada se podnosi žalba u bilo kojoj fazi postupka regrutacije, žalba će imati suspenzivni efekat dok je ne pregleda Komisija za žalbe.

➤ Način prijave i komunikacija s kandidatima:

Zainteresovani kandidati mogu preuzeti prijavi formular u Arhivi J.P.L. "Përparimi" a.d u gradu Vučitrn, ul. "Gjergj Kastriot Skenderbeu" br. 82 (bivši objekat TMK-a pored Osnovnog suda Mitrovica - odeljenje u Vučitrnu) svakog radnog dana od 08:00 do 16:00 časova. Odeljenje za kadrove, u skladu sa članom 8, stavom 3 Administrativnog uputstva MFPT-br. 01/2024 o Uređivanju postupaka konkursa u javnom sektoru, pružiće potrebna pojašnjenja kandidatima u vezi sa kriterijumima javnog konkursa i asistiraće im i davati potrebne upute za prijavu putem elektronske adrese.

Podnošenje prijave sa svom tražnom dokumentacijom u ovom javnom pozivu vrši se isključivo putem sledeće elektronske adrese: hrperparimi@gmail.com.

Sva komunikacija tokom postupka javnog konkursa odvijaće se elektronskim putem, a svaki kandidat biće obavešten pojedinačno.

Napomena: Prijave podnete nakon predviđenog roka neće biti prihvaćene.

➤ Objašnjenje:

Preduzeće ima za cilj da razjasni pitanje termina koji se koriste u rodnom kontekstu, gde reči i naslovi jednog roda uključuju i drugi rod.

➤ Zaključak:

N.P.L. "Përparimi" a.d u Vučitrnu nudi jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Republike Kosova i podstrekava manjinske zajednice i njihove članove, osobe sa invaliditetom i manje zastupljen pol da se prijave.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

